



**Skema Kombëtare e Investimeve, Denaj: Financojmë 50% të investimit grant në serra, blegtori e peshkim**

Faqe 2



**Shpallet lista e fituesve të subvencioneve në bujqësi - Nga mbi 15 mijë aplikantë që kaluan fazën e parë, financohen rreth 4300 fermerë**

Faqe 5



**GIZ mbështet fermerët e Kukësit dhe Dibrës për mbjelljen e mjedrës**

Faqe 7



# AGROBIZNESI



Rr. "Qemal Stafa", P. 9-katësh, Nr. 70, Kati 2, Pazari i ri, Tiranë.  
Tel: +355 4 2 251 910 /911  
Email: info@fedinvest.al  
kontakt@fedinvest.al  
www.fedinvest.al

## BOTIM I KËSHILLIT TË AGROBIZNESIT SHQIPTAR

Adresa: Rruga "Mine Peza", Pallati 87/3, Hyrja 1, Kati i parë, Tel/ Fax: 2229445  
E-mail: infokash@yahoo.com www.kash.org.al

15-ditëshi i parë i muajit shtator 2024

**Viti i shtatëmbëdhjetë i botimit - Nr. 493**  
Çmimi 125 lekë

E përdyjavshme e pavarur

# ROLI I ISO 9001:2015 NË SEKTORIN E BIMËVE AROMATIKE DHE MJEKËSORE NË TIRANË

## FUQIZIMI EKONOMIK I GRAVE PËRMES ZBATIMIT TË STANDARDEVE NDËRKOMBËTARE NË ZINXHIRËT GLOBALË TË VLERËS

Qeveria Zvicerane, nëpërmjet ndërhyrjeve të Programit Global Për Cilësi dhe Standarde që zbatohet nga UNIDO, është e përkushtuar për të adresuar pabarazitë gjinore në sektorin e BAM-re dhe për të fuqizuar gratë si lidere dhe agjente të ndryshimit ekonomik. Përmes kësaj qasjeje, UNIDO synon të transformojë ekonominë dhe të gjenerojë rritje gjithëpërfshirëse, duke siguruar që gratë të kenë mundësi të barabarta për të kontribuar në zhvillimin ekonomik

**Programi Global Për Cilësi dhe Standarde**

UNIDO  
UNITED NATIONS INDUSTRIAL DEVELOPMENT ORGANIZATION

Schweizerische Eidgenossenschaft  
Confédération suisse  
Confederazione Svizzera  
Confederaziun svizra

Sekretariati i Shtetit për Çështjet Ekonomike SECO



**Cilat janë mundësitë që ofron prodhimi organik? - Vetëm 800 hektarë të kultivuara. Eksporte me vlerë më të lartë**

Faqe 2

### SHARTIM APO MBOLASIE

**A janë shqiptarët të parët që aplikuan shartimet!?**



Përgatiti: Koço Mosko  
Boston, MA - SHBA


Faqe 11

### KËNDI I BOTIMEVE TË REJA PËR BUJQËSINË



**Enver Isufi, shkencëtari i bujqësisë, i cili flet me gjuhën e poezisë**

Përgatiti: Shkrimtari Shpendi Topallaj



Faqe 10

### TEMA TË DITËS

- Libri "Jeta misterioze e bimëve" autori Pjerin Preka Fq.12
- Paketa fiskale 2025, biznesi bën gati propozimet - Nga lehtësitë fiskale për sektorë të veçantë, tek tarifat doganore Fq.4
- Agroturizëm "Stani i Hoxhës", oazi që u ofron turistëve kulinarinë tradicionale Fq.5
- Përdorimi i dronëve në bujqësi - Prof. As. Dr. Eqrem Meçollari Fq.13

### LEGJISLACION

**Ndryshime në ligjin për shërbimin veterinar garanton gjurmueshmërinë në zinxhirin ushqimor**



Faqe 4

## Skemë e re aplikimesh për grante në bujqësi - Për çfarë do të përdoret shtesa në buxhet prej 500 milionë lekësh?

Ministria e Bujqësisë do të hapë një skemë të re mbështetjeje për fermerët përmes subvencioneve të dhëna nga buxheti i shtetit. Me aktin normativ të miratuar së fundmi, qeveria ka akorduar një shtesë fondesh për Ministrinë e Bujqësisë në vlerën e 500 milionë lekëve.

Në relacionin që shoqëron këtë dokument, thuhet se shtesa e fondeve në masën 500 milionë lekë për Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, do të shkojë në mbështetje të fermerëve për implementimin e skemës së re të mbështetjeje/ grand për investime, e cila synon të krijojë iniciativë për rritjen e investimeve në sektorin e bujqësisë, me qëllim rritjen e prodhimit, agropërpunimit dhe eksporteve.

Referuar relacionit, shtesa nevojitet për të mbuluar rreth 20-30% të aplikimeve, të cilat i korrespondojnë periudhës shtator-dhjetor 2024.

Pas miratimit të aktit nor-

mativ, Ministria e Bujqësisë ka dhënë disa detaje se ku do të përdoret ky fond. Sipas këtij institucioni, shtesa do të shkojë si mbështetje për fermerët për ndërtimin e serave të reja, po ashtu për herë të parë do të kushtohet vëmendje ndërtimit të rrjetave antibreshër, pasi "pabesitë" e motit në kulmin e prodhimit kanë sjellë dëme të mëdha për prodhuesit. Nga ana tjetër, fondi parashikohet të kanalizohet në ndërtimin e stallave për bagëtitë. Para pak kohësh Ministria e Bujqësisë miratoi një udhëzim për



ndërtimin e sallave sipas standardeve të duhura, ku dhe ishte parashikuar mbështetje për këtë kategori.

Mekanizimi i sektorit të bujqësisë gjithashtu do të marrë vëmendje, duke përfshirë procese të ndryshme në këtë sektor.

Po ashtu do të jepet rëndësi shtimit dhe përmirësimit të ujëtjes dhe kullimit, si një zë shumë i rëndësishëm për të garantuar rritjen e prodhimit dhe cilësinë e tij. Në sektorin e peshkimit fondet do të kanalizohen për rrjetat, me qëllim rritjen e zënieve në det.

## Cilat janë mundësitë që ofron prodhimi organik? - Vetëm 800 hektarë të kultivuara. Eksporte me vlerë më të lartë

Shqipëria ka vetëm 800 hektarë tokë me produkte organike, apo me pak se 1% të sipërfaqes së kultivuar në total. Për të rritur prodhimin "Bio" Ministria e Bujqësisë, Anila Denaj, nxit fermerët që të orientohen drejt këtij prodhimi si mundësi e "artë" për të depërtuar në tregjet ndërkombëtare dhe për të shitur me vlerë më të lartë.

"Prodhimi organik paraqet mundësi të artë për Shqipërinë, sot produktet organike në vendet e botës kanë çmim më të lartë në shitje, tregu është në rritje. Përse Shqipëria mos zërë një pjesë të tregut të BE, do të mundësonte zgjerim të eksporteve".

Gjatë diskutimeve mbi projektligjin për prodhimin organik, etiketimin e produkteve organike dhe kontrollin e tyre, deputetët e komisionit të Veprimtarisë Prodhuese, janë shprehur se duhet rritur mbështetja me financim për prodhimin organik, pasi kostot janë shumë të larta.

"Qe te nxisim bujqësinë organike duhet te japim me shume subvencione. Sepse me bujqësi organike prodhojnë me pak dhe kanë më shume kosto. Nuk kemi ecur fare, duhet të ecim shumë më shumë. Për sipërfaqet qe janë mbi 5 ha, keni dhënë të njëjtën sasi

subvencionesh për ato që kanë më pak hektarë."

"Sot s'ke asnjë leverdi për të kultivuar sipërfaqe organike, këto dy vite deri sa të bëhet efektiv ligji, për çfarë do shër-

komponenti i mbështetjes. Me skemat mbështetëse në dy vitet e fundit, prodhimi organik ka qenë i privilegjuar sepse të gjithë përfitojnë.. Sasia e mbështetjes tek ne është më e



CILAT JANË MUNDËSITË QË OFRON PRODHIMI ORGANIK? VETËM 800 HEKTARË TË KULTIVUARA. DENAJ: EKSPORTE ME VLERË MË TË LARTË

bejnë?

Përfaqësues të Ministrisë së Bujqësisë kanë sqaruar se mbështetja për bujqësinë organike nuk duhet parë vetëm në këndvështrimin e subvencioneve, por edhe të kufizimeve që ekzistojnë, të cilat me këtë projektligj hiqen.

"Miratimi i këtij ligji krijon mundësinë e hartimit të programeve për zbatimin e tij. Po përgatisim planet e veprimtarisë pas ardhjes së progres raportit, ku një komponent i rëndësishëm është prodhimi organik, ku përfshihet dhe

lartë në raport me BE. Por nga ana tjetër, duhet të kuptojmë që nuk është vetëm mbështetja që zhvillon në mënyrë të pakushtëzuar sektorin. Ligji pranon certifikimin në grup, duke qenë se fermat janë të fragmentizuara, sepse kostot e certifikimit janë të larta. Risia e ligjit e sheh gjithë procesin në gjithë zinxhirin e vlerës".

Komisioni parlamentar për Veprimtarinë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin ka miratuar në parim projektligjin, i cili pas miratimit edhe në Kuvend, do të shtrijë efektet ligjore nga viti 2027.

## Me mbështetjen e IPARD-it u realizuan 73 investime në serra

Misiri prej më shumë se 6 vitesh i ka kthyer sytë nga bujqësia.

Ai drejton Shoqërinë e Bashkëpunimit Bujqësor "Grames". Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Anila Denaj bëri të ditur se me mbështetjen e programit IPARD II dhe qeverisë shqiptare, Misiri ka mundur të ndërtojë një serrë prej 2.5 ha, me standarde evropiane, ku kultivimi bëhet me karta teknologjike dhe aplikohet mbrojtja biologjike duke shmangur përdorimin e pesticideve.

Aktualisht kjo sipërfaqe është mbjellë me spec trekolor dhe i gjithë produkti është i kontraktuar për në Spanjë.

Pas përfundimit të vjeljes së specit, serra do të shfrytëzohet për kultivimin e lakrës, e cila do të eksportohet

jashtë.

Përmes fondeve të programit IPARD janë realizuar

si Lushnja, Divjaka, Berati, Fieri e të tjera.

"Kemi kaluar nga 1000



73 investime në serra, të vendosura në zona ku bujqësia po zhvillohet në mënyrë intensive

ha serra në 2200 ha serra në harkun kohor të 7 viteve", informoi ministria.

## Skema Kombëtare e Investimeve, Denaj: Financojmë 50% të investimit grant në serra, blegtori e peshkim

Qeveria miratoi Skemën Kombëtare të Investimeve në Ferma, një instrument mbështetës për të rritur, fuqizuar dhe modernizuar aktivitetin bujqësor të fermerëve dhe blegtorëve, si edhe peshkimin përmes akuakulturës.

Pas mbledhjes së qeverisë, në një deklaratë për mediat, ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural Anila Denaj tha se, përmes Skemës Kombëtare të Investimeve në Ferma, financojmë 50% të investimit grant në serra, blegtori e peshkim.

"Fermerët dhe subjektet përfitues të Skemës Kombëtare me 50% të investimit grant, do të jenë në fushën e serrave që sot kanë rritur sipërfaqet në 2 200 ha tokë, nga 1 mijë ha që ishte para 5 vitesh dhe kjo mbështetje do të rrisë investimet në këtë sektor me 250 ha sipërfaqe serra në vit, duke siguruar një produkt cilësor në zinxhirin ushqimor dhe eksporte në 83 tregje elitare", tha ajo.

Denaj theksoi se, blegtoria është në fokus të mbështetjes së qeverisë.

"Blegtoria është mbështetur fuqishëm nga Skema Kombëtare 2024, me mbi 50% të vlerës totale të subvencioneve për të ulur kostot në prodhim", theksoi ministria.

"Përmes Skemës Kombëtare të Investimeve në Ferma, do të financojmë 50% të investimit grant për infrastrukturën e mbarështimit të kafshëve dhe rritjen e cilësisë së prodhimit", u shpreh Denaj.

Për sektorin e akuakulturës, vijoi ministria, "ambicia e qeverisë shqiptare është për të kapur tregjet ndërkombëtare me 30 mijë ton peshk eksporte në vitin 2030. Sot jemi me 9 600 ton peshk eksporte nga akuakultura dhe për të zhvilluar këtë potencial është e domosdoshme mbështetja me grante nga Skema Kombëtare e Investimeve në Ferma".

Denaj tha se qeveria adreson mbështetje edhe për mekanizimin bujqësor, një sektor i nevojshëm për rritjen e cilësisë së prodhimit dhe uljen e kostove për fermerët.

Ministria zbardhi mbështetjen

financiare për sektorët përkatës, ku bëri të ditur se, "për serrat diellore masa e përfitimit do të jetë jo më shumë se 15 milionë lekë për ha; për serrat për prodhim perimesh jo më shumë se 8 milionë lekë për ha dhe për serrat e rrushit të tavolinës 4 milionë lekë për ha", tha Denaj.

"Masa e përfitimit për rrjetat antibreshër do të jetë jo më shumë se 1,5 milionë lekë për ha duke zbatuar kështu politikat për mbështetjen ndaj ndryshimeve klimatike", u shpreh Denaj.

Sipas saj, Skema Kombëtare e Investimeve në Ferma, nis këtë vit me një buxhet 500 milionë lekë, e miratuar në Aktin Normativ të Qeverisë, por do të vijoj të paguhet dhe për gjatë vitit që vjen.

Denaj informoi se aplikimet për këtë skemë nisin më 1 tetor on-line në Agjencinë e Zhvillimit Bujqësor dhe Rural dhe për aplikantët e rregullt mund të fillojmë edhe këtë vit menjëherë nga pagesat me 30% të investimit grant.

## Rritet eksporti i peshkut, qershori regjistron kulmin

Pavarësisht rritjes së zënies së peshkut dhe produkteve të detit, konsumi dominohet nga importi. Të dhënat zyrtare nga Instituti i Statistikave, tregojnë se në 1 vit, pra nga Qershori 2023-Qershori 2024, në Shqipëri janë importuar 30 mijë ton peshk.

Rritja është reflektuar edhe në vlerë. Muaji Qershori 2024, arrin vlerën më të lartë të importit të peshkut, në rreth 1.36 miliardë

lekë, apo 14 milionë euro.

Ndërsa në total përgjatë gjithë periudhës Qershor 2023-Qershor 2024, janë importuar në total afro 11.1 miliardë lekë peshk dhe produkte të tjera nënujore.

Nga ana tjetër, peshku i eksportuar për të njëjtën periudhë kap një vlerë më të ulët në raport me importin, të regjistruar në 7.8 miliardë lekë dhe po ashtu në sasi, regjistruar në

10.348 ton, ku Qershori 2024 regjistron sasinë më të ulët përgjatë gjithë vitit.

Sipas të dhënave të INSTAT, në vitin 2023, zënia e peshkut nga të gjitha kategoritë ujore, ka qenë 19.338 ton. Duke marrë parasysh zënie mesatare në një vit, del në pah se shumica shkon për eksport dhe pjesa më e vogël mbetet për konsum vendas.

## ROLI I ISO 9001:2015 NË SEKTORIN E BIMËVE AROMATIKE DHE MJEKËSORE NË TIRANË

# FUQIZIMI EKONOMIK I GRAVE PËRMES ZBATIMIT TË STANDARDEVE NDËRKOMBËTARE NË ZINXHIRËT GLOBALË TË VLERËS

*Qeveria Zvicerane, nëpërmjet ndërhyrjeve të Programit Global Për Cilësi dhe Standarde që zbatohet nga UNIDO, është e përkushtuar për të adresuar pabarazitë gjinore në sektorin e BAM-re dhe për të fuqizuar gratë si lidere dhe agjente të ndryshimit ekonomik. Përmes kësaj qasjeje, UNIDO synon të transformojë ekonominë dhe të gjenerojë rritje gjithëpërfshirëse, duke siguruar që gratë të kenë mundësi të barabarta për të kontribuar në zhvillimin ekonomik*

## Roli thelbësor i grave në ekonominë globale dhe fuqizimi i tyre përmes tregtisë

Gratë luajnë një rol thelbësor në ekonominë globale, duke kontribuar jo vetëm nëpërmjet fuqisë së tyre punëtore por edhe si sipërmarrëse. Sipas statistikave, nga rreth 582 milionë sipërmarrës në botë, 252 milionë janë gra, megjithëse përqindja e tyre varion ndjeshëm nëpër rajone të ndryshme. Përveç kësaj, gratë përbëjnë 41% të fuqisë punëtore globale, duke treguar rëndësinë e tyre në zhvillimin ekonomik dhe social. Gratë zotërojnë afro 10 milionë Ndërmarrje të Vogla dhe të Mesme (NVM), sektor i cili përbën rreth 80% të vendeve të punës në mbarë botën. Përmirësimi i cilësisë dhe kapaciteteve të këtyre ndërmarrjeve është thelbësor për krijimin e mundësive të reja të punësimit dhe për fuqizimin ekonomik të grave.

Përtej ndikimit të tyre në biznes, gratë shpesh investojnë më shumë në arsimimin, shëndetin dhe mirëqenien e familjeve të tyre, duke kontribuar në mënyrë të qëndrueshme në zhvillimin afatgjatë të brezave të ardhshëm. Përfshirja e grave në tregtinë globale, veçanërisht përmes zinxhirëve të vlerës globale që përfshijnë 60-80% të gjithë tregtisë ndërkombëtare, është një hap i rëndësishëm drejt fuqizimit të tyre ekonomik. Megjithatë, modelet gjinore të punës në këto zinxhirë shpesh përfshijnë paga të ulëta dhe punë të nënvlerësuar, duke krijuar sfida për barazinë gjinore dhe njohjen e plotë të kontributit të grave. Fuqizimi ekonomik i grave përmes tregtisë mund të ketë një efekt të gjerë dhe të fuqishëm, duke gjeneruar mundësi të reja dhe përmirësuar jetën e shumë njerëzve në komunitetet e tyre.

## Mundësitë ekonomike për gratë në zinxhirët globalë të vlerës dhe nevoja për politika mbështetëse

Zgjerimi i zinxhirëve të vlerës globale dhe ekonomia dixhitale po krijojnë mundësi të reja për fuqizimin ekonomik të grave, duke ndryshuar strukturat tradicionale të tregut dhe duke rritur pjesëmarrjen e tyre në sektorë që më parë dominoheshin nga burrat. Kjo dinamikë jo vetëm që zgjeron rolet e grave në ekonomi, por gjithashtu rrit zgjedhjet e tyre si konsumatore dhe forcon pozicionin e tyre negociues. Studimet tregojnë se tregtia ka një ndikim të drejtpërdrejtë në përmirësimin e pagave të grave, veçanërisht në vendet në zhvillim që rrisin eksportet e tyre, duke ndihmuar kështu në zvogëlimin e hendekut gjinor të pagave. Për shembull, në rastin e dyfishimit të eksporteve të prodhimit, pjesa e grave në pagat totale do të rritej ndjeshëm, duke kontribuar në një rritje të përgjithshme të punësimit dhe përfitimeve financiare për to. Përveç kësaj, gratë që punojnë në sektorë me orientim eksporti shpesh përfitojnë nga vende pune më të qëndrueshme, me përfitime dhe siguri më të mira.

nga standardet globale.

## Rëndësia e barazisë gjinore në zhvillimin ekonomik dhe industrial të qëndrueshëm

Barazia gjinore është një qëllim thelbësor jo vetëm për vetë drejtësinë sociale, por edhe për përmbushjen e objektivave të tjerë të zhvillimit, si reduktimi i varfërisë, rritja ekonomike dhe qëndrueshmëria mjedisore. Për të siguruar që gratë dhe burrat të kenë akses, të marrin pjesë dhe të përfitojnë në mënyrë të barabartë nga projektet zhvillimore, është e nevojshme që çështjet gjinore të adresohen në të gjitha fazat e ciklit të projektit – nga dizajni dhe zbatimi deri te monitorimi dhe vlerësimi. Nëse këto çështje injorohen, ekziston rreziku që pabarazitë gjinore jo vetëm të vazhdojnë, por edhe të përkeqësohen.

Mungesa e statistikave të ndjeshme ndaj gjinisë ka pasoja të gjera. Pa të dhëna të besueshme të ndara sipas gjinisë, vendimet e marra nga politikëbërësit, shkencëtarët dhe studiuesit në fusha si shëndetësia, arsimit ose ekonomia rrezikojnë të lënë pas gratë. Për të shmangur thellimin e pabarazive, është thelbësore të mbushen boshllëqet e të dhënave gjinore dhe të ndërmerren veprime të synuara drejt zhvillimit gjithëpërfshirës dhe të qëndrueshëm. Krijimi i kushteve të favorshme për sipërmarrjen e grave, rritja e aksesit të tyre në burime prodhuese, përfshirja në vendimmarrje dhe promovimi i rolit të tyre në zhvillimin industrial ndihmojnë në krijimin e një bote ku të dyja gjinitë mund të lulëzojnë.

## Fuqizimi i grave dhe barazia gjinore në industrinë globale, roli i UNIDO për zhvillim gjithëpërfshirës dhe të qëndrueshëm

UNIDO është e përkushtuar për të adresuar pabarazitë gjinore në industri dhe për të fuqizuar gratë si lidere dhe agjente të ndryshimit ekonomik. Përmes kësaj qasjeje, UNIDO synon të transformojë ekonominë dhe të gjenerojë rritje gjithëpërfshirëse, duke siguruar që gratë të kenë mundësi të barabarta për të kontribuar në zhvillimin ekonomik. Organizata thekson se Barazia Gjinore dhe Fuqizimi i Grave (GEEW) janë në qendër të mandatit të saj për Zhvillim Industrial Gjithëpërfshirës dhe të Qëndrueshëm (ISID), duke e bërë këtë një pjesë të pandashme të misionit të saj global.

Duke integruar perspektivën gjinore në të gjitha ndërhyrjet e saj, UNIDO synon të krijojë kushte të barabarta për gratë dhe burrat, duke çuar përpara axhendën e saj ISID dhe duke kontribuar në arritjen e Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm (SDG) të përcaktuara në Axhendën 2030. Politika e Barazisë Gjinore dhe Fuqizimit të Grave, e lëshuar në vitin 2019, përcakton qartë angazhimet e UNIDO për barazinë gjinore, si dhe përgjegjësitë dhe llogaridhënien brenda organizatës. Strategjia për Barazinë Gjinore dhe Fuqizimin e Grave 2020–2023 ofron një udhërrëfyes për përshpejtimin e progresit drejt përmbushjes së këtyre angazhimeve, duke kombinuar promovimin e barazisë gjinore me një mjedis pune gjithëpërfshirës dhe planifikim strategjik të përgjegjshëm ndaj gjinisë.

Për të arritur këto qëllime, UNIDO bashkëpunon me partnerë globalë nga sistemi i OKB-së, sektorin privat dhe vendet e ndryshme, duke synuar përfshirjen e grave dhe burrave në të gjitha nivelet për të ndryshuar marrëdhëniet e pushtetit dhe stereotipet gjinore. Këto partneritete ndihmojnë në promovimin e aktiviteteve të bashkëpunimit teknik në fushat tematike të UNIDO, duke mundësuar transformimin e normave sociale dhe krijimin e mundësive të reja për gratë, që të kontribuojnë më fuqishëm në zhvillimin industrial dhe ekonomik.

## Kontributi i Programit Global të Cilësisë dhe Standardeve për fuqizimin e grave

GQSP ofron një qasje holistike për të përmirësuar konkurrencën ndërkombëtare të vendeve përmes integritit të standardeve të cilësisë në çdo fazë të zinxhirit të vlerës. Ky program, i zhvilluar nga UNIDO dhe i financuar nga Qeveria e Zvicrës përmes SECO, përfshin më shumë se 12 vende në katër kontinente, duke përfshirë Shqipërinë, Gjeorgjinë, Perunë dhe Afrikën e Jugut. Duke u fokusuar në rritjen e përputhshmërisë me kërkesat ndërkombëtare të tregut, GQSP ndihmon këto vende të angazhohen më efektisht në tregtinë globale. Ndërhyrjet e synuara për secilin zinxhir vlerash jo vetëm që përmirësojnë cilësinë e produkteve, por edhe forcojnë qëndrueshmërinë ekonomike.

Një nga aspektet kryesore të GQSP është integrimi i barazisë gjinore që nga faza e parë e projektimit të projekteve. SECO e konsideron barazinë gjinore një prioritet në çdo projekt, duke analizuar potencialin e tij për të avancuar barazinë dhe për të kontribuar në rritje gjithëpërfshirëse dhe të qëndrueshme. Udhëzimet gjinore të zhvilluara nga SECO ndihmojnë në identifikimin e boshllëqeve dhe rreziqeve gjinore, ndërsa krijojnë mundësi për inovacion. Kjo qasje ndihmon në ndërgjegjësimin e institucioneve dhe partnerëve për rëndësinë e dimensionit gjinor në zhvillimin ekonomik.

Në mënyrë që të përmirësohet përgjegjësia dhe raportimi lidhur me GEEW, SECO ka zhvilluar sisteme për të monitoruar dhe raportuar treguesit gjinorë. Kjo qasje gjithëpërfshirëse synon të bëjë dimensionin gjinor më të dukshëm në çdo projekt dhe të sigurojë që gratë dhe burrat të përfitojnë në mënyrë të barabartë nga ndërhyrjet e zhvillimit. Në këtë mënyrë, GQSP jo vetëm që rrit cilësinë e zinxhirëve të vlerave, por gjithashtu përparon drejt arritjes së barazisë gjinore në nivelet globale.

## Trajnimi mbi ISO 9001:2015 hapi drejt rritjes së cilësisë dhe tregjeve globale për sektorin e BAM-ve

Në kuadër të projektit GQSP Albania është zhvilluar një trajnim mbi standardin ndërkombëtar të cilësisë ISO 9001:2015. Ky trajnim ka mbledhur aktorë kyçë nga Bashkia e Tiranës, përfaqësues të Drejtorisë së Zhvillimit Rural, përfaqësues të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme dhe fermerët që operojnë në sektorin e Bimëve Aromatike dhe Mjekësore (BAM). Iniciativa përbën një hap të rëndësishëm drejt promovimit të zbatimit të standardeve ndërkombëtare në zinxhirin e vlerës së BAM, duke e vendosur Shqipërinë në një pozitë më konkurruese në tregjet e huaja.

## Synimi i trajnimit dhe përfitimet e ISO 9001:2015 për sektorin e BAM-ve

ISO 9001:2015 është një standard ndërkombëtar i njohur gjerësisht që fokusohet në menaxhimin e cilësisë. Pjesëmarrësit në trajnim patën mundësinë të mësojnë se si ky standard mund të zbatohet në aktivitetet e tyre të përditshme për të përmirësuar cilësinë e produkteve dhe të shërbimeve. Për fermerët dhe sipërmarrësit në sektorin BAM, zbatimi i ISO 9001:2015 mund të përkthehet në produkte me cilësi më të lartë, që i përmbushin standardet ndërkombëtare të sigurisë dhe cilësisë, duke hapur kështu rrugë për mundësi të reja tregtare, veçanërisht në eksport.

Përfaqësuesit e qeverisë lokale, NVM-të dhe fermerët punuan së bashku për të kuptuar më mirë sesi standardet mund të ndikojnë drejtpërdrejt në përmirësimin e procesit të prodhimit, duke reduktuar defektet dhe duke përmirësuar sigurinë ushqimore. Për më tepër, ata u njohën me metodat më të mira për të mbrojtur konsumatorët, duke garantuar që produktet BAM janë në përputhje me kërkesat e tregjeve ndërkombëtare.



Megjithatë, për të realizuar këto përfitime, është e domosdoshme të adresohen barrierat që kufizojnë mundësitë e grave, të tilla si diskriminimi në qasje në financa dhe burime. Pjesëmarrja e ulët e grave në proceset vendimmarrëse për zhvillimin e standardeve kombëtare dhe ndërkombëtare thekson nevojën për politika që promovojnë përfshirjen e grave, duke krijuar një mjedis të barabartë për të gjitha grupet në sektorët e rregulluar

## LEGJISLACION

## Paketa fiskale 2025, biznesi bën gati propozimet - Nga lehtësitë fiskale për sektorë të veçantë, tek tarifatat doganore

Këtë vit, biznesi ka marrë masa më herët për ti paraprirë paketës fiskale 2025. Dhoma e Tregtisë dhe Industrisë Tiranë u ka dërguar një letër sipërmarrjeve anëtare, duke iu kërkuar që të propozojnë ndryshime fiskale të nevojshme për vitin e ardhshëm, propozime të cilat janë depozituar dhe mbledhur deri në fund të muajit Gusht.

Dhoma e Tregtisë Tiranë vë në dukje se sipërmarrja po vuan pasojat e efektit zinxhir të rritjes së çmimeve në tregun botëror. Duke theksuar se bizneset e vogla dhe ato të mëdha po përballen me vështirësi financiare, mungesë likuiditeti, dhe me një situatë të pasigurtë në këndvështrimin e qëndrueshmërisë së biznesit, ku nuk mungojnë dhe rastet e falimentit.

Sipas Dhomës së Tregtisë Tiranë është nevojë imediate hartimi i një pakete të strukturuar të mbështetjes financiare 2025. Sipërmarrja kërkon dhe pret nga qeveria nisjen e aksioneve me politika nxitëse dhe treg-

ues të matshëm në mbështetje të konkurrueshmërisë, inovacionit, dhe nxitjes së eksporteve, për ti dhënë bizneseve një frymëmarrje dhe mbështetje financiare që është e domosdoshme për zhvillimin e qëndrueshëm.

*Por cilat janë shtyllat ku do të fokusohen kërkesat e biznesit*



*për paketën fiskale 2025?*

Kërkesat do të përqendrohen tek problemet që hasin sipërmarrjet me procedurat tatimore dhe që shkaktojnë paqartësi dhe përplasje në zbatim. Krijimin e lehtësirave fiskale për sektorë të caktuar ekonomikë me qëllim lehtësimin financiar të tyre dhe rritjen e konkurruesh-

mërisë. Procedurat dhe tarifatat doganore janë shtylla e dytë, duke u përqendruar tek tarifatat për prodhuesit vendas, të cilat krijojnë pabarazi në raport me rajonin. Marrëveshjet e tregtisë së lirë dhe taksimi i dyfishtë është shtylla e tretë ku do të përqendrohen kërkesat e sipër-

marrjes, duke u fokusuar tek barrierat tatimore që eksitojnë dhe eliminimi i tyre. Lufta ndaj informaliteti do të jetë shtylla e katërt e propozimeve të bizneseve për paketën fiskale të vitit të ardhshëm. Propozimet do të adresohen në Këshillin Ekonomik Kombëtar dhe në strukturat përgjegjëse të qeverisë.

Lufta ndaj informaliteti do të jetë shtylla e katërt e propozimeve të bizneseve për paketën fiskale të vitit të ardhshëm. Propozimet do të adresohen në Këshillin Ekonomik Kombëtar dhe në strukturat përgjegjëse të qeverisë.

## Ndryshime në ligjin për shërbimin veterinar garanton gjurmueshmërinë në zinxhirin ushqimor

Ministrja e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Anila Denaj paraqiti në Komisionin Parlamentar të Ceshitjeve Ligjore ndryshimet në ligjin "Për shërbimin veterinar", që synojnë forcimin e monitorimit dhe inspektimeve në këtë sektor për të garantuar siguri ushqimore sipas standardeve të BE-së.

Ministrja Denaj tha se, "ky është një sektor shumë i rëndësishëm brenda kuadrit të sigurisë ushqimore".

"Ne vijmë me një situatë epizotike shumë të pastër, ndërsa në rajon e vende të tjera ka pasur raste epizotike. Ne kemi ruajtur një situatë epizotike të pastër edhe kur fqinji ynë Greqia u prek nga murtaja. Ndërsa ndryshimet ligjore që parashtrijmë sot e përafrojnë kuadrin ligjor me BE dhe vijmë në linjë me përpjekjet e qeverisë për integrimin në BE", tha Denaj.

Sipas saj, ndryshimet përbushin një rregullor të plotë

sipas BE-së, për prodhimin, kontrollin dhe cilësinë e produkteve veterinarë për të garantuar sigurinë ushqimore

maksimale.

Denaj ftoi qytetarët të denoncojnë rastet e shkeljeve në këtë drejtim, teksa thek-



në vend.

Ajo tha se, ligji i mundëson prodhuesve të rrisin prodhimin ndërsa do të lehtësohen dhe barrierat administrative për regjistrimin e barnave veterinarë të importit.

Sipas saj, produktet veterinarë që tregtohen në 200 farmaci në të gjithë vendin, ndikojnë mbi kontrollin e sëmundjeve dhe korniza e qartë rregullative që paraqitet garanton siguri

soi se është përgjegjësi e të gjithëve të denoncojnë për garantimin e sigurisë ushqimore.

Ministrja tha se, ndryshimet ligjore garantojnë gjurmueshmërinë në të gjithë zinxhirin ushqimor dhe këto risi ligjore reflektojnë 15 propozime të grupeve të interesit dhe aktorëve të fushës që iu përgjigjen nevojave aktuale që paraqet sektori.

## UNIDO

## Fuqizimi ekonomik i grave përmes zbatimit të standardeve ndërkombëtare në zinxhirët globalë të vlerës

*(Vijon nga faqja 3)*

### Përmirësimi i potencialit të eksportit në Shqipëri

Një nga sfidat kryesore për sektorin e BAM-e është përbushja e standardeve ndërkombëtare të cilësisë dhe sigurisë, të cilat janë esenciale për të hyrë në tregjet e huaja. Duke miratuar ISO 9001:2015, bizneset shqiptare në këtë sektor mund të rrisin besueshmërinë e produkteve të tyre në tregjet ndërkombëtare. Në të njëjtën kohë, kjo përmirëson ndjeshëm potencialin e eksportit të Shqipërisë në sektorin BAM, duke hapur dyert për mundësi të reja biznesi në tregje me kërkesa të larta për cilësi dhe siguri.

Trajnimi u përqendrua gjithashtu në rritjen e efikasitetit operacional dhe përmirësimin e performancës së bizneseve. Zbatimi i standardit ISO 9001:2015 mund të ndihmojë kompanitë që të optimizojnë proceset e tyre, duke reduktuar kostot e operimit dhe duke përmirësuar përbushjen e kërkesave të klientëve. Në këtë mënyrë, përfitimi është dyfishtë: cilësi më e lartë dhe një avantazh konkurrues në tregjet vendase dhe ndërkombëtare.

### Fuqizimi ekonomik dhe përfshirja gjinore

Një aspekt i rëndësishëm i këtij angazhimi është përfshirja gjinore. Projekti GQSP Albania dhe mbështetësit e tij theksojnë rëndësinë e fuqizimit ekonomik të grave fermerë dhe sipërmarrëseve. Duke integruar gratë në sektorin BAM dhe duke i pajisur ato me njohuritë dhe aftësitë e nevojshme për të zbatuar standardet ndërkombëtare, ky trajnim kontribuon drejtpërdrejt në përmirësimin e jetesës së tyre dhe në rritjen e përfshirjes së tyre në vendimmarrje.

Për gratë fermerë dhe sipërmarrëse, përfshirja në standardet ISO mund të sjellë përfitime të mëdha, duke i ndihmuar ato të zhvillojnë aftësi të reja, të rrisin cilësinë e produkteve të tyre dhe të zgjerojnë tregjet e tyre. Për më tepër, trajnimet e tilla kontribuojnë në rritjen e vetëbesimit të grave në sektorin agrar, duke i inkurajuar ato të ndjekin mundësi të reja të biznesit dhe të jenë pjesë aktive e zhvillimit ekonomik të vendit.

### Ndërtimi i besimit në tregje lokale dhe globale

Zbatimi i standardeve ndërkombëtare, siç është ISO 9001:2015, nuk sjell vetëm përfitime në aspektin operacional dhe të cilësisë, por gjithashtu kontribuon në ndërtimin e besimit me partnerët tregtarë dhe konsumatorët. Për bizneset në sektorin BAM, ky besim është kyç për suksesin e tyre afatgjatë. Duke pasur një standard ndërkombëtar të njohur si ISO, ato mund të tregojnë një angazhim të fortë për cilësi, çka ndihmon në krijimin e marrëdhënieve të qëndrueshme me tregtarët dhe klientët.

Në përfundim, trajnimi mbi ISO 9001:2015 për sektorin e BAM-ve përfaqëson një hap të rëndësishëm drejt zhvillimit të qëndrueshëm dhe rritjes së potencialit eksportues të Shqipërisë. Përmes bashkëpunimit shumëpalësh, ky trajnim krijon themelet për një të ardhme të qëndrueshme dhe të suksesshme për sektorin e BAM, duke fuqizuar fermerët, gratë dhe sipërmarrësit e rinj, si dhe duke përmirësuar cilësinë e produkteve të tyre në tregjet globale.



## AKTUALITET

## A do hapet eksporti për vezën e kategorisë A?! Gati programi për kontrollin e salmonelozës

Shqipëria prej shumë vitesh vijon të eksportojë në Bashkimin Europian, vezë të kategorisë B.

Ndonëse në pularitë vendase prodhohet vezë cilësore e kategorisë A, gjatë eksportit ato klasifikohen si vezë të kategorisë B, vetëm për përdorim në industrinë ushqimore.

Ekspertët e sigurisë ushqimore kanë ngritur disa herë shqetësimin që të eksportohet vezë "Klasa A" në BE duhet të plotësohen kërkesat e legjislacionit të BE dhe konkretisht zbatimi i rregullores 2160/2003 të BE "Për kontrollin e salmonelozës dhe shkaktarëve të tjerë të sëmundjeve zoonotike nga ushqimet. Ky plan sipas tyre duhet të miratohet nga BE.

Për hapjen e eksportit të vezëve të kategorisë A, Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural tha për Monitor se ka përgatitur një program të ri të kontrollit të salmonelozës që do t'i dërgohet për vlerësim BE-së.

"Në lidhje me hapjen e eksportit të vezës së klasit A, Shqipëria që prej vitit 2011 në mënyrë të vazhdueshme kërkon hapjen e eksportit të vezës së klasi A.

Në vazhdimësi edhe këtë vit MBZHR-ja i ka drejtuar Komisionit Europian kërkesën për hapjen e eksportit të Vezës

së klasit A. Është përgatitur një Program Kombëtar i kontrollit për salmonelozën në pulat për vezë (Gallus Gallus) 2024, në përputhje me kërkesat e fundit të legjislacionit të BE-së, i cili do të dërgohet në Bruksel për vlerësim", pohoi Ministria e Bujqësisë.

Vezët klasifikohen sipas cilësisë më poshtë: a) vezët e Klasës A ose të "freskëta" janë për konsum të drejtpërdrejtë nga njerëzit dhe për t'u përdorur në industrinë ushqimore ose joushqimore; b) vezët e Klasës B dorëzohen vetëm në industrinë ushqimore për përpunim termik (përpunimi termik në industrinë ushqimore nëpërmjet linjave teknologjike të kontrolluara eliminon mikroorganizmat që mund të jenë të dëmshme për njerëzit).

Ky aktivitet është kontrolluar disa herë nga ekspertët e BE-së (Food and Veterinary Office) dhe kanë konstatuar se plotësohen kërkesat e legjislacionit të BE-së për këto produkte. Aktualisht janë 5 kompani në 6 vendndodhje që kanë të drejtën të eksportojnë vezë Klasa B, vezë të lëngët dhe produkte vezë në BE.

Për ekspertin e menaxhimit të fermave Edi Fero pritet që edhe programi i ri të mos i japë zgjidhje çështjes së eksportit të vezëve, pasi në 10 vite nuk ka pasur përmirësim në nivelin e sigurisë së prodhi-

meve shtazore.

Ai thotë se në fermat e rritjes së shpendëve nuk mungojnë investimet bashkëkohore, por mosinteresi i shtetit për të monitoruar zbatimin e standardeve, që veza të mos shkojë me antibiotik, që të kryhen protokollet e mjekimeve dhe vaksinimeve, nuk mundëson hapjen e eksportit.

"Pas ndjekjes së këtyre procedurave ftohet Komisioni Europian i hapjes së eksporteve në Shqipëri që verifikon kontrollin. Nëse masat janë zbatuar hapet eksporti për çdo fermë", thotë ai.

Sakaq tregu i pularive çdo vit rrezikohet nga mbiprodhimi, teksa konsumi i vezëve sipas kompanive prodhuese, 2 vitet e fundit ka tendencë rënë nga emigracioni i popullsisë. Në eksport kompanitë largojnë tepricat e prodhimit, për shkak të çmimit të ulët të shitjes, pasi veza vlerësohet e kategorisë B.

Vetëm vjet për disa muaj rresht veza shqiptare u eksportua me fitim. Rënia drastike e prodhimit nga pandemia e influencës aviare në Europë, rriti ndjeshëm çmimin e shitjes së vezës për eksport. Për 2023 sipas të dhënave të Doganave eksportet e vezës u rritën rreth 4 herë më shumë se 2022. Kjo ishte sasia më e lartë e vezëve të eksportuara që prej vitit 2013.

## Si do të shpërndahen 500 mln lekë shtesë në bujqësi? - Nga serrat e reja, tek rrjetat antibreshër dhe sektori i peshkimit


Qeveria ka miratuar një shtesë fondesh për Ministrinë e Bujqësisë në vlerën e 500 milionë lekëve. Vendim ky që ishte parashikuar që në fillim të hapjes së aplikimeve për skemën kombëtare të subvencioneve 2024, pasi fondi i vënë në dispozicion prej 3.2 miliardë lekësh ishte i pamjaftueshëm në raport me fluksin e aplikimeve nga ana e fermerëve. Numri i aplikantëve arriti në më shumë se 71 mijë, ku interes të lartë ka pasur për naftën falas për punime të mekanizuara në bujqësi.

Por si do të ndahet kjo shtesë në buxhet? Sipas Ministrisë së Bujqësisë, shtesa do të shkojë si mbështetje për fermerët për ndërtimin e serave të reja, po ashtu për herë të parë do të kushtohet vëmendje ndërtimit të rrjetave antibreshër, pasi "pabesitë" e motit në kulmin e prodhimit kanë sjellë dëme të mëdha për prodhuesit.

Nga ana tjetër, fondi parashikohet të kanalizohet në ndërtimin e stallave. Para pak kohësh Ministria e Bujqë-

sisë miratoi një udhëzim për ndërtimin e sallave sipas standardeve të duhura. Mekanizimi i sektorit të bujqësisë gjithash-

nënvizuar se mbështetja për fermerët është shumë e ulët në raport me atë që japin vendet e rajonit dhe se nevojat për fondin



tu do të marrë vëmendje, duke përsheptuar procese të ndryshme në këtë sektor.

Po ashtu do të jepet rëndësi shtimit dhe përmirësimin të ujitjes dhe kullimit, si një zë shumë i rëndësishëm për të garantuar rritjen e prodhimit dhe cilësinë e tij. Në sektorin e peshkimit fondet do të kanalizohen për rrjetat, me qëllim rritjen e zënieve në det.

Ekspertët shpesh herë kanë

e dhënë në formë grantesh arrijnë në rreth 100 milionë euro në vit. Megjithatë duke marrë në konsideratë dy vitet e mëparshme dhe performancën që do të kenë të ardhurat në buxhet, bujqësia mund të jetë përfutuese e një shtese tjetër financimi.

Buxheti total fillestar i Ministrisë së Bujqësisë për vitin 2024 ishte programuar në rreth 14.2 miliardë lekë.

## “Ambasadorët e rinj të mjedisit”, ndikim pozitiv në komunitet

Ministrja e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Anila Denaj ndau disa nga momentet më të bukura të projektit “Ambasadorët e rinj të mjedisit” për një mjedis më të pastër dhe më të qëndrueshëm në Sarandë.

Nga trajnimet, ditët e

pastrimit të plazheve në Sarandë, mbjellja e luleve, dhe deri te vendosja e koshave të riciklimit, ky grup i motivuar të rinjsh kanë ndikuar pozitivisht në komunitet.

“Ambasadorët e rinj të mjedisit,” janë pjesë e Programit

Rajonal mbi Demokracinë Vendore në Ballkanin Perëndimor 2 (ReLOaD2), i cili financohet nga Bashkimi Evropian dhe zbatohet nga UNDP, në bashkëpunim me Qendra Youthful dhe Bashkinë Sarandë.

## ISUV, garanci për cilësinë dhe sigurinë e ushqimeve

Gjatë periudhës 1 janar – 15 gusht të këtij viti, ISUV ka analizuar 8 353 kampione për të garantuar sigurinë ushqimore.

Ministrja e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Anila Denaj bëri të ditur se përmes analizave dhe kontrolleve të vazhdueshme, garantohet cilësia dhe siguria e ushqimeve që arrijnë në tryezat e konsumatorëve, si brenda ashtu dhe jashtë vendit.

“Siguria ushqimore është një përparësi dhe ISUV është në vijën e parë për ta garantuar”, theksoi ajo.

Gjatë periudhës janar-gusht

nga ana e ISUV u kryen 411 autokontrolle për eksport, 1 812

kontrollime zyrtare, 6 112 monitorime si dhe 18 teste proficence.



## Agroturizëm “Stani i Hoxhës”, oazi që u ofron turistëve kulinarinë tradicionale

Në Novosejë, të Kukësit, në zemër të natyrës dhe freskisë së pyjeve, Gëzim prej 8 vitesh ka ngritur agroturizmin “Stani i Hoxhës”.

Ministrja e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Anila Denaj ndau në rrjete sociale rastin e Gëzimit, si një ndër shembujt që është kthyer në trend tashmë nga shumë fermerë dhe

banorë të zonave rurale, që investimet në prodhime tipike të zonës, po iu shërbejnë për t'i kthyer fermat apo shtëpitë e tyre, në oaze të mikpritjes turistike.

“Ky oaz i qetesisë dhe shijes së mirë mirëpret turistë vendas e të huaj për të shijuar kulinarinë tradicionale dhe natyrën e mrekullueshme të vendit tonë”,

u shpreh Denaj.

Ministrja tha se falë natyrës favorizuese dhe klimës së begatë, Gëzimi mbarështon bletë dhe prodhon mjaltë për nevojat e agroturizmit.

Ai kultivon 120 pemë dardhe dhe 3 dynmë patate, duke u siguruar që vizitorët të ndjejnë shijen e vërtetë të prodhimeve autoktone.

## Shpallet lista e fituesve të subvencioneve në bujqësi - Nga mbi 15 mijë aplikantë që kaluan fazën e parë, financohen rreth 4300 fermerë

Agjencia për Zhvillimin Bujqësor dhe Rural ka shpallur listën përfundimtare të ap-

fermerë individë që përfitojnë mbështetje financiare për fara dhe fidanë;

fermerë. Mbështetja për këtë sektor do të jetë në vlerën 10 mijë lekë për krerë për tufa me mbi 10 krerë lopë për fermë dhe për bagëtitë e imta do të jepen 1200 lekë për krerë për tufa mbi 100 krerë për fermë.

Sa të takon financimit të naftës, rezulton se nga 54.255 aplikime për mbështetje me naftë për punime të mekanizuara në bujqësi, janë përzgjedhur 23.190 prej tyre apo afro gjysma e fermerëve që kanë kërkuar mbështetje.

Sipas Ministrisë së Bujqësisë, fondit prej 3.2 miliardë lekësh do të shpërndahet në mënyrë proporcionale tek përfutuesit, për të mos lënë asnjë pa mbështetje. Pas shpalljes së listës, do të nisnin procedurat për disbursimin e fondeve. Skema e mbështetjes me naftë këtë vit ka ndryshuar dhe nuk do të bëhet përmes kartave si vitet e kaluara, por me para të cilat do të kalojnë në llogaritë e fermerëve.



likantëve që do të përfitojnë mbështetje me subvencione nga buxheti i shtetit.

Referuar të dhënave zyrtare nga ky institucion, nga 15.591 aplikime që kanë kaluar fazën e parë të përzgjedhjes për 7 masat e Skemës Kombëtare, janë shpallur fitues përfundimtarë 4273 fermerë.

Konkretisht janë 441 grupime fermerësh dhe 89

1722 fermerë do të përfitojnë nga mbështetja e dhënë për bletarinë në vlerën e 1 mijë lekëve për zgjua për ferma me të paktën 50 zgjoje.

Blegtoria ka dhe numrin më të lartë të përfutuesve, me 2021 fermerë në total, nga të cilët për mbështetjen për tufën bazë të matrikulluar të gjedhit janë 70 dhe për tufën bazë të të imtave do të financohen 1951

## INFORMACIONE

## Rama: “Hani i Gështenjave”, një tjetër sipërmarrje agroturizmi hap dyert në Qafë Plloçë

Pogradeci po tërheq gjithnjë e më shumë vizitorë vendas dhe të huaj, falë ofertës së plotë turistike që ofron.

Vitet e fundit oferta turistike e këtij qyteti po zgjerohet edhe nga rrethet tona, ku bukuritë natyrore dhe investime në agrobujtinë, po zgjojnë interes të veçantë tek turistët për t'u vizituar.

Kryeministri Edi Rama ndau në rrjetet sociale pamje nga “Hani i Gështenjave”, një tjetër sipërmarrje agroturizmi ka hapur dyert në Qafë Plloçë të Pogradecit, ngritur në një pikë strategjike nga mund të shihet i gjithë qyteti dhe liqeni i Pogradecit.

“Mes natyrës përrallore të zonës, mikpritjes së ngrohtë pogradecare dhe ushqimit tradicional të gatuar me mjaft

mjeshtëri, kjo bujtinë nuk duhet lënë pa u vizituar”, u shpreh Rama.

I rrethuar me bukuri natyrore, peizazh piktoresk, objek-

aventurës.

Agroturizmi është një mundësi e mirë për zhvillimin e kësaj zone, ku investimet në vepra publike, rrugë rurale,



te historike dhe kulinari tradicionale kjo zonë ofron shumë mundësi edhe për turizmin e

ujësjellës nuk mungojnë dhe bukuritë natyrore ruhen me fatnatizëm nga banorët e fshatit.

## Kullota me qira brenda zonave të mbrojtura - Udhëzimi: Veprimtaria të mos cenohet vlerat dhe funksionet natyrore e biologjike të territorit

Ministria e Turizmit dhe Mjedisit ka përcaktuar procedurat që duhet të ndiqen për dhënien me qira të kullotave që ndodhen brenda zonave të mbrojtura. Sipas udhëzimit Agjencitë rajonale të Zonave të Mbrojtura dhe Zyra e Administrimit të Parqeve Kombëtare do të duhet që brenda datës 15 shkurt të çdo viti, të përcaktojnë parcelat kullorore publike dhe private që mund të jepen për përdorim për kullotje.

Ndërkohë që, ky proces duhet të kryhet në përputhje me legjislacionin në fuqi për kullotat dhe zonat e mbrojtura, që ka një sërë kufizimesh

për shkak të ndikimit negativ që mund të sjellë mospërdorimi i duhur i këtyre territoreve.

Udhëzimi i ministrisë përcakton se për dhënien me qira të territoreve kullota, mbahet në konsideratë që veprimtaria e kullotjes të mos cenohet vlerat dhe funksionet natyrore e biologjike të territorit kullor, si dhe të jetë në harmoni me elementet e vlerave të biodiversitetit që ajo ka

Subjektet e interesuar duhet të paraqesin kërkesën me shkrim pranë bashkisë përkatëse brenda datës 30 mars, për kullotat verore dhe brenda datës 10 korrik, për

kullotat dimërore. Ndërkohë që, afati për dhënien në përdorim të kullotave është 5 vjet me të drejtë rinovimi.

Gjithsesi, këto rregulla nuk do të aplikohen për parcelat e ndodhura në kullotat që ndodhen në nënzonën qendrore të zonës së mbrojtur përjashtohen nga përdorimi sipas kërkesave të këtij udhëzimi.

Përdorimi i territorit të kullotave është vënë në qendër edhe të një projektligji të depozituar nga deputetja socialiste Edona Bilali, e cila ka kërkuar lejin e ndërtimit të centraleve fotovoltaike dhe eolike brenda tyre.

## Gati projekti për 9 mole të reja dhe dy markata peshku - Denaj: 25 milionë euro financim, projekti përfundon në 2026

Qeveria shqiptare ka garantuar një financim prej 25 milionë eurosh në formë kredie nga qeveria italiane, i cili do të shkojë për infrastrukturën e peshkimit.

Gjatë prezantimit të ndryshimeve ligjore në ligjin e peshkimit në Komisionin Parlamentar të Çështjeve Ligjore, theksoi do të ndërtohen 9 mole ku tregtohet peshku artizanal dhe dy markata të cilat do të nxitin rritje të sektorit të peshkimit, përpunimit dhe më shumë punësim.

“Marrëveshja financiare ratifikohet në Parlament këtë vit, projekti fillon vitin tjetër. Te gjitha këto infrastruktura do bëhen në të njëjtën kohë që të kompletohet gjithë vija bregdetare. Në fillim të 2026 do

jenë efektive”.

Ky projekt pritet të ndihmojë në formalizimin dhe mod-

regjistroi 144 milionë euro eksporte të produkteve peshkore gjatë vitit 2023. Në total janë



GATI PROJEKTI PËR 9 MOLE TË REJA DHE DY MARKATA PESHKU DENAJ: 25 MILIONË EURO FINANCIM, PROJEKTI PËRFUNDON NË 2026

ernizimin e sektorit, duke rritur konkurrencën dhe zhvillimin e tij të qëndrueshëm. Shqipëria

230 anije peshkimi tregtar profesional dhe afro 600 varka të vogla.

## Sa fermerë do të marrin pagesë për naftën në bujqësi? - Lista/ “Kalon” vetëm gjysma e aplikantëve, kryeson qarku Fier

Lista e aplikantëve që kanë kaluar “testin” për të përfituar naftë falas për punime të mekanizuara në bujqësi është bërë publike. Agjencia për Zhvillimin Bujqësor dhe Rural ka

fondi prej 12 milionë eurosh për këtë qëllim do të ndahet në mënyrë propocionale mes aplikantëve që plotësojnë kriteret e nevojshme, duket se përgjysmimi i tyre ka të bëjë me prob-


Ndërsa qarku që ka më pak përfitues rezultojn të jetë Kukësi me vetëm 66 të tillë.

Përfitimi për sipërfaqen që kultivohet varion: deri në 100% të vlerës, për fermerët/aplikantët me sipërfaqe deri në 10 hektarë. Ndërsa për sipërfaqen mbi 10 hektarë, masa e përfitimit zvogëlohet me 50%, përjashtuar rastet e aplikantëve me status “grup fermerësh” ose “SHBB”.

Skema e mbështetjes me naftë këtë vit ka ndryshuar dhe nuk do të bëhet përmes kartave si vitet e kaluara, por me para të cilat do të kalojnë në llogaritë e fermerëve.

Ministria e Bujqësisë është shprehur se po punohet për të arritur një marrëveshje me bankat tregtare që të mundësohen llogari me kosto të reduktuar për ata fermerë që janë përfitues të naftës.

Ministria e Bujqësisë kishte programuar që numri i përfituesve nga skema e naftës për vitin 2024 të ishte 31.500 individë.



SA FERMERË DO TË MARRIN PAGESË PËR NAFTËN NË BUJQËSI? LISTA/ “KALON” VETËM GJYSMA E APLIKANTËVE, KRYESON QARKU FIER

shpallur emrat e përfituesve, ku rezultojn se nga 54.255 aplikime për mbështetje me naftë për punime të mekanizuara në bujqësi, janë përzgjedhur 23.190 prej tyre apo afro gjysma e fermerëve që kanë kërkuar mbështetje.

Duke qenë se Ministria e Bujqësisë është shprehur se

lematika në këtë drejtim.

Por si është shpërndarja në qarqe? Të dhënat tregojnë se qarku Fier, ku dhe bujqësia është me e zhvilluar, është ai që kryeson për nga numri i përfituesve me afro 9878 të tillë, ndjekur nga Qarku i Korçës, Beratit, Shkodrës, Elbasanit dhe Vlorës.

## Impianti i ujit që transformon mbetjet në energji dhe produkte të tjera!

Nga hapja e një rubineti deri te shpëlarja e tualetit, pak prej nesh shpesh ndalojnë të marrin në konsideratë ndikimin mjedisor të përdorimit të ujit. Procesi i sigurimit të ujit të pastër dhe i trajtimit të atij uji pasi ta kemi përdorur, megjithatë, ka një gjurmë të konsiderueshme karboni. Në fakt, në shumë vende, energjia e nevojshme për të pompuar dhe trajtuar ujin tonë mendohet se shton deri në 5% të të gjitha emetimeve të gazeve serrë, një shifër e krahasueshme me industrinë e aviacionit.

Disa orë pasi dikush shkon në tualet në kryeqytetin e Bullgarisë, Sofje, ajo që derdhet zakonisht përfundon në impiantin e trajtimit të ujërave të zeza në Kubratovë. E operuar nga Sofijska Voda, pjesë e

grupit Veolia, uzina është një nga më eficientët në Europë për

Ky biogaz më pas shndërrohet në energji elektrike dhe



energjinë.

“Ne mblehim ujërat e zeza nga qytetarët e Sofjes. Ne e trajtojmë këtu që të jetë i pastër kur të hyjë në lumë. Në këtë proces, ne prodhojmë biogaz.

nxehtësi. Nxehtësia përdoret për proceset tona dhe energjia elektrike plotëson nevojat e këtij centrali,” tha Stanislav Stanev, Drejtor Teknik në Veolia Bulgaria.

## Eksportet drejt Kinës, rritje me 25 %

Eksportet shqiptare drejt Kinës shënuan rritje me 25 % gjatë gjashtëmujorit të parë të këtij viti krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë.

Instituti i Statistikave (INSTAT) raportoi se në 6-mujorin e këtij viti eksportet e mallrave shqiptare drejt Kinës llogariten në vlerë 5.3 miliardë lekë, nga 4.2 miliardë lekë të eksportuara në 6-mujorin e 2023-shit.

Ndërkohë, importet e mallrave, referuar INSTAT, arritën vlerën 42.4 miliardë lekë. Në të njëjtën periudhë të 2023-shit u importuan 46.7 miliardë lekë

mallra.

Shqipëria eksporton drejt Kinës kryesisht minerale, ndërsa importon makineri, pajisje dhe pjesë këmbimi vlera e të cilave gjatë këtij 6-mujori llogaritet 20.4 miliardë lekë.

Po ashtu tekstile dhe këpucë, me vlerë gati 4.9 miliardë lekë, produkte kimike e plastike me vlerën mbi 6.5 miliardë lekë dhe dhe materiale ndërtimi e metale me vlerë 5.9 miliardë lekë.



## GIZ mbështet fermerët e Kukësit dhe Dibres për mbjelljen e mjedrës

Kultivimi i mjedrës, një kulturë e re në vendin tonë, shihet nga ekspertët në fushën e bujqësisë si një aktivitet fitimprurës, ndërsa kërkesa në treg po vjen në rritje.

Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Anila Denaj, ftoi fermerët nga Kukësi dhe Dibra të bëhen pjesë e një skeme mbështetëse nga Agjencia Gjermane për Zhvillim (GIZ).

“Një iniciativë e re që sjell mundësi të reja për fermerët nga Kukësi dhe Dibra, duke përfutur nga mbështetja e ekspertëve fitoni përvojë në kultivimin e mjedrave, një kulturë e re dhe fitimprurëse që ka kërkesë të lartë në treg”, tha Denaj.

Bashkëpunimi me partnerë

strategjikë, si GIZ, theksoi ministria, sjell rezultate të prekshme për komunitetet tona.

GIZ mbështet fermerët për një sipërfaqe nga 0,2 ha deri 0,4 ha me fidanë, agrotekstilin sistemin e ujitjes dhe barin e fisnikëruar ndërmjet rrjeshtave të mbjella.

Fermerët duhet të sigurojnë burimin e ujit për ujitje dhe



pompën, kryejnë përgatitjen e tokës, sistemin mbështetës prej druri, përfshirë telat dhe plehrat dhe produktet për mbrojtjen e bimëve sipas udhëzimeve të ekspertëve

Ky projekt pilot ka për qëllim të përdorë përvojën nga Kosova për të siguruar të ardhura të mira dhe të qëndrueshme për familjet dhe banorët në rajonet malore. Mjedrat janë me kërkesë të lartë në treg, duke u ofruar fermerëve një mundësi fitimprurëse për të përmirësuar të ardhurat dhe jetesën e tyre.

Afati për aplikim mbyllet nesër, datë 20 gusht.

Mjedra bën pjesë në grupin e pemëve manore me vlera të larta ushqyese dhe ekonomike. Ajo është e pasur me vitamina, minerale dhe antioksidantë.

## Drejtoresha e panairit “ITB Berlin”, Rothe: Shqipëria të jep esencën e një mikpritjeje të mirë

Drejtoresha e Përgjithshme e panairit më të madh të turizmit në botë ITB Berlin, Deborah Rothe deklaroi se Shqipëria të jep menjëherë esencën e një mikpritjeje të mirë.

Në një intervistë televizive, Rothe tha se “që në vizitën time të parë në Shqipëri, një vit më parë në Tiranë, më ra në sy dhe e ndjeva mikpritjen e vendit dhe të njerëzve. Është një ndjenjë e ngrohtë, ndihesh shumë i mirëpritur dhe ke mundësi të vendosësh kontakt direkt me njerëzit. Për mua personalisht, kjo është esenca e një mikpritjeje të mirë. Kjo ka bërë që ne të marrim këtë vendim dhe që Shqipëria të vendoset në fokusin tonë si një nga të paktat vende të rëndësishme për ne që mund të ishte mikpritëse në ITB Berlin dhe njëkohësisht e të gjithë industrisë botërore të turizmit të ne, në qendrën tonë të panairëve në Berlin”.

“Si vend mikpritës i ITB Berlin, je njëkohësisht mikpritës i gjithë botës, që do të thotë e gjithë industria e turizmit dhe këtu kam parasysh gati 100 mijë njerëz nga e gjithë bota që do të udhëtojnë në Berlin për ta përdorur panairin si platformë nxitëse për bizneset e tyre”, tha Rothe.

Rothe u shpreh se “Shqipëria ia doli sidomos gjatë dhe pas kohës së pandemisë që të prezantohej si një vend shumë i sigurt dhe mendjehapur e kjo solli si rezultat edhe më shumë turistë. Ajo që bie në sy njëkohësisht me këtë trend është që turistët janë të përhapur shumë thellë në të gjithë vendin. Kjo do të thotë se nuk ka një sezon kohor dhe gjeografik të përcaktuar qartë, nuk ka një kalendar nisjeje dhe përfundimi gjatë vitit, por përkundrazi kemi një shpërndarje gjithëvje-

tore dhe në të gjithë vendin. Ka mjaftueshëm vend dhe hapësira për shumë njerëz dhe po ashtu ka mjaftueshëm mundësi për t’u prezantuar si me malet ashtu dhe në det dhe plazhe. Kjo shumëllojshmëri e vendit, vlerësohet me të drejtë dhe nga turistët dhe ndaj edhe vijmë”.



Drejtoresha e Përgjithshme e Panairit më të madh të turizmit në botë thekson se ka nevojë ende për përmirësime në kuadër të turizmit, por gjithsesi vendi është në rrugën e duhur.

“Është shumë e rëndësishme të përgatisni infrastrukturën, mbi të gjitha për turistët ndërkombëtarë. Ne e vëmë re se disa po bëhen gati me shpejtësi si aeroporti i ri ndërkombëtar i Vlorës, apo rikonstruksioni i linjës hekurudhore, në mënyrë që t’u jepet mundësia edhe turistëve të udhëtojnë brenda vendit, që të mos mbeten të detyruar të presin makinën apo autobusin, por të lëvizin në mënyrë të lirshme në vend. Besoj se kjo infrastrukturë është kryesore mes nevojave dhe detyrimeve për t’i mirëpritur turistët ndërkombëtarë. Ajo që ndjej unë është një pasion i

madh, pasion për vendin, për ta prezantuar atë tek të huajt me të gjitha bukuritë e tij, shpirtin e shqiptarëve por sidomos këtë shumëllojshmëri që e përshkrova më sipër”, nënvizoi Rothe.

Ky, vijoi ajo, është edhe thelbi i nevojshëm i asaj që duhet të shkruhet mbi Shqipëri-

në në media, që të kuptohet se si funksionon ky vend, që të kuptohet se sa të hapur dhe se sa mendjehapur për më tepër janë këta njerëz që janë shumë të lumtur të përshëndesin botën e turizmit ndërkombëtar.

E pyetur me çfarë ndjesish po largohet, Rothe tha se “ajo që ndjej unë është një pasion i madh, pasion për vendin, për ta prezantuar atë tek të huajt me të gjitha bukuritë e tij, shpirtin e shqiptarëve por sidomos këtë shumëllojshmëri që e përshkrova më sipër”.

“Jemi shumë të lumtur që kemi këtë bashkëpunim, kemi zhvilluar një fushatë shumë të bukur së bashku dhe mezi po pres mbrëmjen hapëse gala, ku Shqipëria në skenë do të jetë me të gjithë traditat e saj për të prezantuar më së miri këtë vend të bukur”, tha ajo.

## Përdorimi i biokarburanteve pritet të rritet në 7 % në 2030-n

Qeveria shqiptare parashikon të rrisë përdorimin e biokarburanteve me 1 % çdo vit për të arritur në fund të 2030-ës nivelin 7 %.

Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë ka hedhur për konsultim publik projektligjin “Për prodhimin, transportimin, tregtimin dhe përdorimin e biokarburanteve dhe të lëndëve të tjera djegëse, të rinovueshme, për transport”.

MIE në relacionin e projektligjit shpjegon se synon promovimin e prodhimit dhe të përdorimit të burimeve të energjisë së rinovueshme për sektorin e transportit, nëpërmjet përdorimit të biokarburanteve për zëvendësimin e një pjese të nënprodukteve të naftës me lëndë djegëse jo fosile për motorët me djegie të brendshme.

Draftligji “Për prodhimin, transportimin, tregtimin dhe përdorimin e biokarburanteve dhe të lëndëve të tjera djegëse, të rinovueshme, për transport” parashikon në 18 nene mënyrën sesi do të aplikohet tekta parashikon si vitin e parë të zbatimit vitin 2025.

“Shqipëria është e angazhuar në kuadër të Acquis të plotësojë Objektivin kombëtar për Energjinë e Rinovueshme. Sasia minimale vjetore në treg e biokarburanteve dhe e lëndëve të tjera djegëse, të rinovueshme, për transport, të cilat plotësojnë kriteret e qëndrueshmërisë në përputhje me nenin

6 të këtij ligji dhe reduktimit të emetimeve të gazeve serrë për biokarburantet, duhet të jetë jo më pak se 1 % të sasisë të konsumi perfundimtar të lendeve djegëse në sektorin e transportit në vitin 2025. Nga viti 2026 deri në vitin 2030 kjo sasi do të rritet gradualisht me 1% të vit me synim që në vitin 2030 të jetë jo më pak se 7%“, citohet relacioni.

Qëllimi i ligjit është të krijohet politika të tilla nxitëse për kultivimin të



bimëve energjetike në Shqipëri dhe mundësinë e përdorimit të biomasave me origjinë të ndryshme për të garantuar mbrojtjen e mjedisit nëpërmjet respektimit të kriterëve të qëndrueshmërisë dhe reduktimit të emetimeve të gazeve serrë për biokarburantet, biolëngjet dhe lëndët djegëse nga biomasa, si dhe plotësimin e kërkesave për cilësinë e karburanteve

në sektorin e transportit referuar parashikimeve në direktivën 2018/2001KE, të Parlamentit Europian dhe të Këshillit, datë 11 dhjetor 2018, “Mbi promovimin e përdorimit të energjisë nga burimet e energjive të rinovueshme”, amenduar se fundmi me direktivën.

Për nxitjen e përdorimit të biokarburanteve dhe regjimi fiskal për prodhuesit parashikohen edhe lehtësi.

“Zbatimi i regjimeve fiskale lehtësues për biokar-

burantet me qëllim rritjen e përdorimit dhe konkurrimit me çmimin. Lehtësitë dhe përjashtime fiskale në lidhje me sasinë e biokarburanteve të pastra 100% bio, pa përfshirë pjesën e nënprodukteve respektive të prodhuar nga përpunimi i naftës bruto, që hidhen në treg, të cilat do të përcaktohen në ligjet respektive të tatimeve dhe taksave”, thuhet në relacion.

## Denaj: Shkolla profesionale në Golem, mundësi të rinjve për tregun e punës

Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Anila Denaj ftoi të rinjtë që të aplikojnë për të studiuar në shkollën profesionale “Charles Telford Erikson” në Golem.

Denaj tha se “me një fokus të veçantë në aftësitë praktike dhe përgatitjen profesionale

Ministria Denaj solli shembullin e Adit dhe Gerit, të cilët zgjedhën shkollën profesionale “Charles Telford Erikson”.

Adi Gjuzi, 15 vjeç tha se zgjodhi shkollën profesionale “Charles Telford Erikson” në degën e agroturizmit, pasi Shqipëria po zhvillohet shumë

urohemi që ushqimet të jenë bio dhe me cilësi të lartë”, tha Gjuzi.

Ai i bëri apel bashkëmoshtarëve të zgjedhin shkollën profesionale për një punësim të sigurt.

Gerit u shpreh se “kam zgjedhur degën agrobujqësi zgjedha këtë degë pasi kam familjarët që kanë 2 ha vreshta. Di shumë procese, por dua të mësoj akoma më shumë që t’i vijë në ndihmë jo vetëm biznesit familjar, por edhe komunitetit. Duke zgjedhur drejtimin bujqësi përfitoj bursë të plotë”.

Eugeni një ish-nxënës që ka mbaruar studimet dhe menaxhon biznesin e tij, si dhe Florenci një ish-nxënës tashmë mësues pranë shkollës, ndajnë eksperiencën e tyre, duke ftuar të rinjtë e tjerë të aplikojnë.

Kjo shkollë ofron edhe drejtimet Hotelieri-Turizëm dhe Ekonomi-Biznes.

Të interesuarit mund të aplikojnë në e-Albania në shërbimin “Regjistrohu në klasën e dhjetë”, deri më 30 shtator.



kjo shkollë ofron drejtimet bujqësi dhe veterinarë duke u dhënë mundësi të rinjve të bëhen gati për tregun e punës, dhe të kontribuojnë në vizionin Bujqësia 2030”.

në fushën e turizmit dhe njerëz nga gjithë bota po vizitojnë vendin tonë.

“Agroturizmi nuk është vetëm për turizmin, por edhe për bujqësinë prandaj ne sig-



SHOQATAT ANËTARE

AVALB FEDINVEST BKFSH EKR IBMA HABA AOA UPM LEAA ADAMA ABA SHGF ALBAFLOR

SHKPVF RKUK SVP MSHKM BIOADRIA PPAM SHT UOTSH KEA BIOPANT ADAD PSN

KËSHILLAT RAJONALE

TIRANA DURRESI FIERI ELBASANI SHKODRA DIBRA

LEZHA GJIROKASTRA KORÇA BERATI VLORA KUKESI



Këshilli i Agrobiznesit Shqiptar

[www.kashalbania.org](http://www.kashalbania.org)

Këshilli i Agrobiznesit Shqiptar





# KREDI E SHPEJTË MIKRO PËR ÇDO QËLLIM BIZNES APO INDIVID

**KREDI MIKRO**

deri në **2,500,000** LEKË



**FED**  
invest 

**GJITHMONË  
FINANCË SOCIALE**


## KËNDI I BOTIMEVE TË REJA PËR BUJQËSINË

## Enver Isufi, shkencëtari i bujqësisë, i cili flet me gjuhën e poezisë

Përgatiti: Shkrimtari Shpendi Topallaj



Shkrimtari Shpendi Topallaj

Prof. Ass. Enver Isufi,  
Agronom në Mbrojtjen e Bimëve  
dhe Bujqësinë Biologjike

Servantesi duke folur për poetët ka dhënë: **“Thjeshtësia është një virtut që nuk gjendet shpesh te poetët, sepse secili prej tyre e mendon veten si më të madhin e botës.”**

E ka thënë këtë katërqind vite më parë, atëhere kur poezia dhe poetët zinin një vend të respektuar në shoqëri. Sot vrulli i jetës me egërsinë e saj të pamëshirshme, i ka larguar njerëzit nga bota sentimentale. Pranohet haptazi se kemi shumë poezi dhe pak lexues.

Pa tjetër që ka pa fund edhe poetë që me thjeshtësinë dhe modestinë e tyre, si nxënës të Epikurit, jetojnë pa u dukur dhe as që i shkon ndërmend ta quajnë veten as më të madhin e lagjes, por të vendit e të botës jo se jo.

Njëri nga këto poetë të thjeshtë është padyshim Prof. Ass. Dr. Enver Isufi, shkencëtar në shkencat bujqësore. Po ndalem në këtë shkrim mbi librin e tij me poezi të zgjedhura me titull **“THELLËSIA E THJESHTËSISË”**. Këtë titull e kam zgjedhur, sepse i shkon përshtat karakterit të tij. Këtë cilësi dalluese të tij ai e ka shpalosur te ky libër. Do ndalem në disa vargje të marra nga vjershat e tij, për të ilustruar sadopak filozofinë e vjershave.

Modestisë, të cilën ai e vlerëson shumë te njerëzit, i ka kushtuar këtë poezi

**MODESTIA**

**Unë jam veç një gjethe  
S'e bëj dot kurorën  
Unë jam veç një pemë  
S'e bëj dot pemëtoren  
Unë jam veç një lule  
S'e bëj dot lulishten  
Unë jam veç një zog  
S'e sjell dot pranverën  
Unë jam veç një fjalë  
S'e bëj dot fjalinë  
Unë jam veç një emër  
S'e bëj historinë  
Unë jam veç një notë  
S'e bëj melodinë  
Unë jam diçka  
Po jo gjithçka**

Enver Isufi, qysh në fillim të librit u drejtohet lexuesëve me modestinë e tij. Ai thotë “unë nuk jam as shkrimtar, as poet” Por kur është i tillë mund të thotë dikush, pse na e këshillon që ta lexojmë këtë autor? Atë e thotë vetë Enveri, por nuk e pranoj unë dhe redaktori i poezive të tij poeti mirënjohur Demir Gjergji.

Përgjigjen për këtë na e jep i ndieri, poeti Demir Gjergji, një nga nxitësit dhe inkurajuesit e poezive të tij.

Ja si shprehet poeti D. Gjergji: “Në këtë libër nuk ka mani për të habitur me figurat të “thella”, (errëta), për të na befasuar, qoftë me metrikë mjeshtërore, qoftë me struktura moderne të kohës. Në këtë libër shfaqet shpirti i njeriut të tokës dhe të shkencës, të drurëve, frutave, luleve, shfaqet fisnikria e tij në raport me shoqërinë, buron respekti dhe nderimi i tij për miqtë dhe kolegët. Bie në sy përpjekja e Enverit për ta kthyer shkencën në një ligjerim praktik e të thjeshtë, për ta transmetuar mençurinë me thjeshtësi.

Ai vetë thotë: “Është jashtëzakonisht e vështirë të jesh i thjeshtë dhe i kuptueshëm, është fare lehtë të jesh i ngatërruar për t'u kuptuar”. Vetë jeta është e ngatërruar, detyra jonë është ta deshifrojmë, ta thjeshtësojmë, pa e vulgarizuar.

Kështu edhe duhet lexuar ky libër, pikërisht te thjeshtësia është thellësia e gjithçkaje. Për më tepër është i madhi Dritëro Agolli, i cili pasi ka lexuar disa nga këto vjersha, thotë “Vjersha të tilla të Enverit, duken të thjeshta, por duan kulturë për t'i kuptuar”. Kultura nuk mungon te vetë autori i këtyre poezive, i cili është njëri nga shkencëtarët e bujqësisë dhe plot pasion e dijeni. Fushat e tij të kërkimit dhe zbatimit në praktikë janë në fushën e Mbrojtjes së Bimëve nga sëmundjet dhe dëmtuesit dhe në Bujqësinë Biologjike. Enveri është bashkëthemelues i Institutit të Bujqësisë Biologjike (viti 2009). Me këtë sistem bujqësie miqësore me shendetin dhe mjedisin, ai merret që nga viti 1997, vit kur filloi Lëvizja për Bujqësinë Biologjike Shqiptare.

Enveri ka kryer studime pasuniversitare në disa institucione shkencore evropiane, por më gjatë ka studiuar në Gjermani. Ka botuar 12 libra profesionale dhe me qindra artikuj këshillues dhe shkencorë. Ka drejtuar për shumë vite revistën periodike “Bujqësia Biologjike”. Në çdo bisedë me të, kushdo mund të konstatojë shqetësimin që ai ka për kthimin e bujqësisë sonë te tradita. Ai njuh feramat prodhuese (ka punuar agronom në zonën e Kryevidhit) dhe punonjës shkencor për 20 vjet në Institutin e Mbrojtjes së Bimëve, Shkozë, Durrës.

Poezitë e tij janë të lexueshme dhe të kuptueshme që nga fermerët, lexuesit e zakonshëm, e deri të intelektualët dhe njerëzit e letrave.

Po shkëpus disa pjesë nga vjershat e tij, ku shkrihet filozofia, satira dhe humori.

**“Pseudointelektualë, janë ata që gomarit i thonë kalë”  
“Intelektualët, të cilët nuk dalin dot mbi palët, ka mundësi t'i kenë pis shalët”**

Në vjershën Dekorata: **“Kur përsonave të pamerituar u jepen dekorata/ Është njëlloj si të vadisësh një bimë me gjethe të thata”**

Vjershën Fjala **“Zgjidhe mirë fjalën para se ta nxjerrësh/ Siç zgjidhet fara para se ta mbjellësh”**

Në vjershën Administrata **“Kush bën karrierë me ashensor/ Dhe nuk e ka provuar se çfarë janë shkallët/ Si vetes edhe gjithkujt/ Ka rrezik t'hyej dhëmballët”**

Ose: **Te njeriu, vlerat e tija/ Nuk maten siç matet hija.**

Te vjersha Inteligjenca dhe populli: **Shoqëria ja ngjanë një kokrrë gruri/ Amidoni është populli/ Embrioni është intelgjenca**

**Amidoni dhe Embrioni/ Japin e marin për mbijetësë/ Pa embrionin e vogël/ Gruri nuk ka shtesë.**

Në vjershën Liberalizimi i trurit: **Shqipëria jonë e dashur/ Nëse dëshiron të ngresh lart e më lart vlerën e Flamurit/ Liberalizo çmimin e trurit/ Injorimi i çmimit të trurit/ Është shkaku i parë/ Përse shqiptarët mbetën gjithmonë shtegtarë**

Enveri e shikon botën me të gjitha ngjyrat e saj dhe thekson se të parit bardh e zi, vetëm sa i vërshtirëson dhe i vonon

proceset e çdo fushe zhvillimi.

Te vjersha Dashuria: **Dashuria nuk ka as armë/As ushtri/ Dashuria mbron vehten dhe të tjerët, po me dashuri”** Më pak vargje poeti qartëson raportin e shtetit me individin **Rasti keq kur shteti para individit jo fajtor sillet si cub/ Kur shteti para keqbërsëve struket si pula/ Shtetit i ka humbur vula**

**Në këto raste nuk flitet më për demokraci/ Në këto raste zotëron hibridi i saj/ E quajtur anarshi**

Autorin e trondit fakti që shqiptarët po lënë vendin e tyre dhe ikin ku të mundën.

Ai thotë: **Më shumë u kënaqa në stan/ me plot lopë, dele e dhi**

**Sa sa në bllokun e vilave të lagjes sime/ Ku nuk banon asnjë njeri.**

Në mbi 300 poezitë e tij gjen shumë nga ato që trajtojnë problemet sociale.

Ose po me këtë temë **“Shtëpia ime e vjetër në fshat Atje në cep të dritares**

**Një dallandyshe kishte bërë folenë  
Dallandysheja m'u drejtua mua me cicërimat e saj  
Ore, i zoti i shtëpisë, Ku je ti?  
Unë kam 25 vite që shkoj e vij nga kontinentët e huaj  
Dhe banoj te shtëpia juaj  
Mua më duket shtëpia ime  
Ty të duket shtëpia e huaj.**

P. sh. te vjersha “Lypësi”  
**Kush nuk ndien dhëmbje/ Kur ka pranë një lypës  
Ai nuk është njeri, është ripërtypës.**

Një vjershë e bukur është ajo e ullirit:  
**Një ulli një farmaci  
Një pemë ulliri, minierë floriri  
Nëse nuk keni pranë kishë ose xhami  
Shkoni e faluni nën një ulli  
Do ndieni të njëjtën qetësi.**

Një buqetë vjershash Enveri ia ka kushtuar personaliteteve të artit, kulturës, shkencës, sportit, figurave patriotike.

Vjersha të tilla ka qenditur për Ismail Kadarenë, Dritëro Agollin, Xhevahir Spahion, Vaçe Zelën, Moikom Zeqon, Gjergj Vlashing, Panojot Panon, Nënë Terezën, për ortopedin popullor Cen Bulkun si dhe për shkencëtarët e bujqësisë.

Këto vjersha janë shprehje e mirësisë së tij. Libri lexohet dhe rilexohet me endje.  
**Po e mbyll këtë shkrim përsëri me thëniet e Enverit: Poezitë e zakonshme Janë pije freskuese  
Poezitë e mira Janë ilaçe kuruese  
Poezitë e dobëta lexohen e rilexohen për t'i kuptuar  
Poezitë e bukura lexohen dhe rilexohen për t'i shijuar  
Lexues dhe lexuese të nderuara  
Ju meritoni fjalë dhe shkrime  
Si arra të qëruara.**

**Unë, autori i këtyre rradhëve, ju këshilloj ta gjeni dhe ta lexoni këtë libër. Është libër për të gjithë.**

## SHARTIM APO MBOLASIE

## A janë shqiptarët të parët që aplikuan shartimet!?

Përgatiti: Koço Mosko, Boston, MA - SHBA

Nëqoftëse do t'i referohemi historisë botërore të shartimeve, mendohet se aplikimet e para janë kryer që në Persinë e Lashtë por, nuk ka të dhëna



të mjaftueshme që të na e vërtetojnë. Shumë autorë të tjerë mendojnë se shartimi i pemëve ka lindur në Mesdhe, para dhe gjatë periudhës së antikitetit greko-romak. Për këtë ka shumë dëshmi e shkrime dhe thuhet se është shumë më i lashtë se kaq.

Procesi i shartimit në dialektin lokal, trevat e Gjirokastrës, por jo vetëm, quhet: "mbolas" ose "mbolasie". Pema që rrjedh

nga ky proces, quhet "mbolë". Mendoj se fjala "mbolë" apo "mbolas", mjaft e përshtatshme për këtë proces, rrjedh nga gjuha shqipe e vjetër ose pellazgjishtja.

Në fjalorin e gjuhës shqipe nuk është e pasqyruar kjo fjalë, e kanë zëvendësuar me fjalën "shartim". Unë e gjej si të përshtatshme edhe këtë fjalë, sepse para se të mbolaset shartohet nënshartesa, por procesin e shartimit e përcakton më mire fjala "mbolas" dhe "mbolë", sepse tani jo të gjitha bimët që mbolasen nënshartesa shartohet.

Ndoshta fjalën mbolas gjuhëtarët e kanë përcaktuar si fjalë që rrjedh nga gjuha greke, dhe e kanë hequr. Unë nuk e di se si mund të etimologohet greqisht kjo fjalë, por për mendimin tim fjala "mbolas" ose "mbolë" është shqipe e pastër.

Detarët në lashtësi në anijet e tyre vendosnin një pjesëz të vogël tek kufiri ku anija duhet të mbulohej nga uji, e quhej në shqipen e vjetër ose pellazgjisht



"embolo", pra e mbulon. Edhe tek shartimet jo të gjitha pemët shartohen me njëra-tjetrën. Sic kemi dardhë me goricë, kumbull me qershi e pjeshkë

e shumë të tjera. Pra gorica e pranon dardhën "embulon" kanë thënë të parët tanë.

Etimologjia e fjalës "mbolë", hedh pak dritë edhe

shqiptare dhe "Dardhanelet", Dardanelet. Mendoj se është një traditë e trashëguar brez pas brezi dhe përbën një eksperiencë të rrallë, unike dhe të



vyer në historinë e kultivimit dhe përmirësimit të bimëve.

Gjatë periudhës bizantine e osmane, ka të dhëna se kjo metodë ishte e zhvilluar nëpër

kopshtet e manastireve dhe pashallarëve osmanë. Historianët tregojnë se kopshtarët më të zotë në atë periudhë, kanë qenë shqiptarët, të cilët sigurisht duhet ta kishin ushtruar këtë zanat shumë kohë më parë. Këto të dhëna na çojnë në mendimin se paraardhësit e shqiptarëve, duhet të kenë qenë ndër të parët në Mesdhe dhe Evropë në këtë drejtim. Mirpo shkrime apo fakte që të na e vërtetojnë, mungojnë. Për t'i zbardhur këto çështje mund të përbëjë objekt studimi për studjuesit bimore ndoshta dhe për gjuhëtarët. Ndërsa fjala "mbolë", "mbolasje" për mendimin tim duhet të jetë në fjalorin e shqipes së bashku me fjalët: "shartim" e "shartesë", tregon se sa e pasur dhe e thellë është gjuha jonë.

Sot shartimet kanë evoluar shumë, kryhen jo vetëm për shtimin dhe përmirësimin e pemëve, por kryhen edhe në të gjitha bimët barishtore e më gjerë.

## Simon Calder, gazetari i famshëm i BBC dhe Independent: Shqipëria "ylli i këtij viti" në turizëm

Shqipëria sërish është vendosur në qendër të vëmendjes së mediave botërore si destinacion turistik.

Këtë herë është gazetari i famshëm i mediave britanike si BBC dhe Independent, Simon Calder, i cili së fundi është bërë "tifozi" i bregdetit shqiptar, duke ua këshilluar të gjithëve në Britaninë e Madhe.

Kryeministri Edi Rama publikoi këtë të diel intervistën e Calder, në të cilën theksohet se Shqipëria është "ylli i këtij viti" në turizëm.

"Nëse po kërkon diçka të përballeshme shkoni në Portugali. Ata kanë një ofertë të shkëlqyer ose në Lindje, në Bullgari, apo Maqedoninë e Veriut. Dhe "ylli" i këtij viti është Shqipëria", thotë ai, teksa po jepte këshilla për zgjedhjen

e vendeve për të pushuar.

"E çfarë vlerësimi më

më parë, me vizitat e para si reporter kurioz përpara viteve



domethënës mund t'i bëhej Shqipërisë teksa sezoni i verës po mbyllet, se sa nga Simon Calder, gazetari i famshëm i mediave britanike si BBC dhe Independent, i cili zbulimin e vendit tonë e ka nisur dekada

'90 në Shqipërinë e një tjetër kohe, ndërsa së fundi është bërë "tifozi" i bregdetit shqiptar, duke ua këshilluar të gjithëve në Britaninë e Madhe si "yllin e këtij viti" në turizëm", u shpreh Rama.

## Kumbaro-Mexhiti: 480 mijë vizitorë nga RMV kanë vizituar Shqipërinë

Ministrja e Turizmit dhe Mjedisit, Mirela Kumbaro zhvilloi një takim me

të Republikës së Maqedonisë së Veriut, Izet Mexhiti, gjatë punimeve të Konferencës së

turistike, ku rreth 480 mijë vizitorë nga RMV, ose 28% më shumë deri në muajin korrik, kanë vizituar Shqipërinë.

Gjithashtu Kumbaro dhe Mexhiti u diskutua edhe për mbarëvajtjen e punëve të përbashkëta në administrimin e pasurive të çmuara natyrore natyrore që bashkëndajnë dy shtetet si liqeni i Ohrit dhe ai i Prespës.

Mbi të gjitha, theksoi Kumbaro "u bisedua edhe për avancimin e projektit për krijimin e parkut të madh ndërkufitar mes tre shtetesh, me Parkun tonë Natyror Korab-Koritnik, Parkun e Mavrovës dhe Parkun e Maleve të Sharrit në Maqedoninë e Veriut dhe Parkun Kombëtar të Sharrit në Kosovë".



Zëvendëskryeministrin e Parë dhe ministër i Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor

Ambasadorëve "Diplo 2024". Në takim mes dy homologëve u bisedua për flukset e shtuara

## Kumbaro: Nga Zipline, te natyra e bujtinat mikpritëse, eksperiencat unike në Theth

Thethi, fshati malor në zemër të Alpeve Shqiptare, është kthyer në një prej destinacioneve më të vizituara nga turistët vendas e të huaj në çdo stinë të vitit.

Turistët tashmë kanë mundësinë për të kaluar mbi kodrat, lumin e Shalës dhe luginën e tij, duke shijuar pamjet e mrekullueshme dhe adrenalinën përmes një Zipline të teknologjisë së fundit.

Ministrja e Turizmit dhe Mjedisit, Mirela Kumbaro publikoi në rrjetet sociale pamje nga Thethi, si ftesë për ta vizituar në këto ditë me temperatura të larta.

"Ja eksperiencat unike në Theth, jo veç me natyrën, por tanimë edhe me atraksionet si Zipline bashkë me mikpritjen e ngrohtë në bujtina e buzëqeshjen e ëmbël të banorëve", tha Kumbaro.

I gjendur në qendër të Parkut Kombëtar, Thethi rrethohet nga bukuri të papërsëritshme natyrore dhe shtrihet mes majave të thepisura nga ku buron edhe lumi i Shalës.

Me ndërtimin e Zipline, Thethi shton një mundësi tjetër për tërheqjen e më shumë vizitorëve dhe krijon një shans të

ri për të promovuar bukuritë natyrore të kësaj zone.

shira në "Paketën e maleve", e cila po përgatitet dhe është



Parku Kombëtar i Thethit ndodhet rreth 70 km larg Shkodrës. Ai është i vizitueshëm në të katër stinët, ku në pranverë dhe verë njihet për gjelbërimin e rrallë, në dimër për bardhësinë e dëborës dhe për lojërat aventureske me të, ndërsa vjeshta për ngjyrat mahnitëse dhe begatinë në frutikulturë.

Projektet për Thethin si një destinacion europian turistik, krahas përfitimit të titujve të pronësisë për shtëpi e bujtina, si dhe të një sërë masave të përf-

drejt përfundimit, – janë pjesë e objektivit të qeverisë për zhvillimin e qëndrueshëm të kësaj zone të veriut, duke krijuar një ekuilibër midis natyrës, zhvillimit turistik, ekonomisë, kulturës dhe komunitetit.

Qeveria ka prezantuar së fundi edhe projektin për "Thethin e së nesërme", që në harmoni me të gjitha elementët e tjerë, do ta lehtësojë vendimin e shumë emigrantëve të këtyre zonave, që të kthehen të investojnë në agroturizëm e bujtina.

## Prodhimi italian i vajit të ullirit në krizë - Shkak, nxehtësia ekstreme dhe thatësira!

Prodhimi i vajit të ullirit në Itali, veçanërisht në rajonin jugor të Pulias, po përballlet me pasojat e të nxehtësisë ekstreme dhe thatësisë.

Në provincën e Foggia-s, të korrat e këtij nëntori pritet të jenë 50-80% më pak se vitin e kaluar, sipas Pietro Leone, i cili menaxhon një kompani bujqësore.

Diga Capaccio është një


nga katër rezervuarët që siguron ujë në krahinë për qëllime industrie, vaditjeje dhe pijeje.

Ajo ushqehet nga një përrua që transporton ujin e shiut në rezervuar.



# Libri "Jeta misterioze e bimëve" autori Pjerin Preka

Libri "Jeta misterioze e bimëve" e autorit Pjerin Preka është një tentativë e "brishtë" e tij të përafrojtë lexuesin me botën bimore pak ose aspak të njohur, me jetën e sofistikuar të bimëve dhe me aktivitetin "shoqëror" të tyre në komunitetin vegetativ, marrëdhëniet dhe ndërveprimi me



organizmat e tjera e në mënyrë të veçantë me rolin vendimtar në mbijetesën e "banorëve" të tjerë të planetit.

Në kushtet aktuale të ndryshimeve klimatike që ambienti ekologjik imponon, njohja e mekanizmave jetësore, e menyrës së komunikimit të bimëve me organizmat e tjera si dhe në mënyrë të veçantë përshtatja me sukses e tyre me kushtet klimatike në evolucion të vazhdueshëm, merr rëndësi themelore në përballjen e shoqërisë njerëzore me dëmet e prodhimeve bujqësore të provokuara nga rritja e temperaturave të ajrit, e thatësirës së zgjatur apo e përmbytjeve të terreneve etj. Tashmë shkencat biologjike konsiderojnë sistemet bimore si zgjidhja e vetme dhe alternativa më racionale e zbutjes së efekteve negative të ndryshimeve klimatike dhe e rivendosjes së ekuilibrit ekologjik të planetit.

Në rrugëtimin e shkurtër të njohjes së fenomeneve jetësore të bimëve, autori propozon "braktisjen" e ideve megalomane të superioritetit njerëzor dhe aplikimin e një racionaliteti sa më objektiv në bashkëjetesë me eksperiencën subjektive njerëzore.

Bota bimore na propozohet "e heshtur", kështu siç e perceptojmë ne dhe eksperienca njerëzore e pranon të tillë sepse bimët nuk flasin. Vetë njeriu nuk shtrou asnjëherë pyetjen se këtyre krijesave u mungon me të vërtetë zëri apo ne nuk e degjojmë atë? Kjo sepse në realitetin objektiv zëri është shprehje e ndërveprimit të subjekteve në hapsirat në mes "vehtes" dhe "tjetrit" në një ambient relacionesh i cili në realitet mungon.

A është koha pra të provojmë ekzistencën e "zërit bimor"? Në ç'mënyrë mund ta degjojmë ne atë?

Në jetën e tyre të përditëshme bimët përdorin instrumenta të ndryshëm të komunikimit. Në fundin e viti 2011, kokrrat e misrit të verdhë vendosin të thyejnë "heshtjen" me anë të frekuencave të sinjaleve të tyre. Në një laborator shkencor në Bristol në Angli ato dërgojnë një klik "muzikor" i dëgjueshëm për veshët tanë, (pa dyshim me ndihmën teknike të instrumentave), si dëshmi e ekzistencës së aftësisë komunikative në forme tingujsh. Ta konsiderojmë pra

këtë si një sinjal "zyrtar" nga ana e bimëve të mundësive natyrale të tyre në prodhimin e tingujve dhe komunikimin me organizmat me të cilat bimët bashkëjetojnë.

Libri përqendrohet më shumë në mënyrat e komunikimit të bimëve me njëra-tjetrën dhe me organizmat e tjera, sinjalet që ato shkëmbejnë në mes tyre për mbrojtjen nga parazitët bimorë. Autori flet për ndërgjegjen bimore dhe për një komunitet vegetativ me veçoritë që e karakterizojnë atë si solidariteti, ndihma reciproke etj.

Ai e mbyll vepren e tij me kapitullin e fundit që siç e quan ai "Kapitulli i reflektimit të autorit" të cilin po e sjellim të plote.

## Kapitulli V Reflektimi i autorit ...

Të pranosh bimët në grupin e qenjeve të gjalla nuk zbeh aspak inteligjencën e njeriut por përkundrazi e vendos atë në thellësi të vizionit autentik të krijimit planetar.

Në të gjithë historinë e mendimit perëndimor gjurma filozofike Aristoteliane i ka atribuar jetës bimore gjithmonë një pozicion inferioriteti duke i renditur bimët në vendin e fundit të organizmave tokësore, më pranë botës inorganike. Një interpretim i tillë i jetës vegetative nuk u njeh bimëve karakteristika të tilla si ndjeshmëria, perceptimi i stimujve ambientale, pa folur pastaj për komunikimin dhe interpretimin e sinjaleve etj.

Po përse pra njeriu e ka të vështirë të kuptojë e të pranojë bimët si qenje të gjalla autentike? Mos vallë nga frika e humbjes së pozicionit dominant dhe të arrogancës të species njerëzore ndaj pjesës tjetër të botës edhe pse ai përbën vetëm 0,1%-0,5% të prezencës mbi tokë?

Ja si konsiderohet p.sh. humbja e jetës së specieve të ndryshme bimore dhe shtazore (përfshirë edhe njeriun) nga dikush:

Vdes një bimë por për këtë "dikush" "bima thahet", vdes një kafshë por për këtë "dikush" "kafsha ngordh". Sepse, sipas këtij "dikushi", vetëm njeriu vdes. Bima mund të thahet por jo të vdesë ndërsa kafsha nuk mund të vdesë por vetëm të ngordhë.

Mos vallë jeta njerëzore është më e çmueshme dhe e rëndësishme se sa jeta e organizmave të tjera, të ndryshme nga ajo e njeriut? Ndoshta sepse garanton më shumë jetëgjatësinë dhe mbijetesën në këtë planet?

JO, aspak, sepse eksperienca e jetës së njeriut mbi tokë tregon që është ai që po kërkon "të shpejtojë" fundin e botës me ndotjet ekologjike, "gropen" e ozonit, mbinxehjen e planetit dhe eliminimin e specieve të rëndësishme për zinxhirin ekologjik etj, etj, etj.

Janë vetëm bimët ato që sigurojnë të ardhmen e sistemit tokësor. Vetëm ato rikthejnë ekuilibret natyrale të planetit dhe stabilitetin e tij në kohra.



Ja një shembull tjetër i arrogancës njerëzore:

Njeriu flet për patologjinë e "fundit", të ashtuquajturën "gjendje vegetative", kur dikush humbet aksidentalisht në mënyrë të pakthyeshme lidhjet me botën e jashtme, sepse sipas tij në këto kushte ai ngjan më shumë me bimët të cilat "vegjetojnë" por nuk "jetojnë".

E megjithatë, në jetën e përditshme, hipokrizia njerëzore përdor metafora të tilla "bimore" si "lulëzon shpirti i njeriut", "lulëzon arsyeja e njeriut" etj.

Mos ndoshta njeriu ka frikë nga gjuha e "pafolur" e bimëve dhe e pakuptueshme për të? Sepse në realitet bimët komunikojnë në mes tyre por ne nuk i "dëgjojmë" dhe nuk i kuptojmë ato.

Fjalët kimike që bimët përshtetisin janë specifike në atë çfarë ato kërkojnë të transmetojnë.

Në kulturën e sotme perëndimorë ekziston Njeriu dhe Natyra që do të thotë se Natyra nuk është humane dhe njeriu është mbi gjithshka. Kur është fjala për Inteligjencën njeriu e personifikon atë me prapshitesën "njerëzore", pra INTELIGJENCA NJERËZORE sepse, sipas tij, inteligjenca mund të jetë vetëm pronë e njeriut. Dhe gjithnjë sipas këtij arsytimi ne, njerëzit, kemi kryer hapin gigand përpara dhe papritmas jemi bërë inteligjentë. Ne jemi të bindur që inteligjenca është një privilegj vetëm i yni.

Realiteti është ndryshe. Rrotull nesh ekzistojnë tipe të ndryshme të inteligjencës difuze tek bimët. Për këtë kërkohet forcë e madhe mendimi dhe ndërgjegjësimi që të rishikohen në mënyrë radikale raportet tona me botën që na rrethon.

Mentaliteti antropologjik e diskriminant i njeriut buron nga vetë diferencat në mes të jetës së bimëve dhe asaj të kafshëve (përfshirë njeriun). Bimët janë autotrofe (nga greqishtja autòs=vete dhe trophè=ushqim)

dhe nuk mund të spostohen ndërsa kafshët janë heterotrofe (nga greqishtja eteros=tjeter dhe trophè=ushqim) dhe vetëlëvizin.

Bimët si organizma autotrofe mund të prodhojnë materiale të përbëra nga substanca inorganike ndërsa kafshët dhe njeriu, si organizma heterotrofe, duhet të ushqehen me organizma të tjera për të përvetësuar substanca organike të gatshme në pamundësi që t'i përpunojnë ato. Një organizim i tillë i jetës mbi tokë, i përshtatur përherë e më shumë gjatë evolucionit, ka larguar gjithnjë e më tepër kafshët nga bimët. Kafshët (përfshirë edhe njeriun) janë perfeksionuar në lëvizjet e shpejta, në shkathtësinë fizike etj, ndërsa bimët në përshtatjen më të plotë të organizmit e të funksioneve të tij ndaj ambientit ekologjik duke garantuar gjithnjë e më tepër mbijetesën dhe riprodhimin e tyre. Në strukturën fizike të bimës pjesë të veçanta të saj si rrënja, degët dhe gjethet janë aq të pavarura sa dhe të lidhura me njëra-tjetrën dhe me krejt organizmin. Nga kjo pikëpamje bima mund të konsiderohet si një koloni, siç ndodh me bletët ku secila prej tyre organizohet në shërbimet e komunitetit. Sjellja e bimës nuk është frut i vendimit të centralizuar të ndonjë organi më inteligjent të saj. Siç e dimë asaj i mungon sistemi nervor qendror, pra truri, dhe krejt struktura nervore që do të mundësonte transmetimin e informacionit. Megjithatë bimët komunikojnë me bimët e tjera dhe me kafshët dhe janë gjithnjë autonomë nga njeriu.

Ndryshe ndodh me njeriun i cili varet gjithmonë nga bimët pasi ato janë i vetmi burim i oksigjenit mbi tokë, i ushqimit tonë, dhe i çfardo lloj energjie të domosdoshme për jetën njerëzore. Bimët zhvillojnë të njëjtin aktivitet jetësor si dhe kafshët por në një mënyrë tjetër, krejtësisht specifike. Ato nuk mbrohen nga parazitët dhe armiqtë

e tyre duke vrapuar siç ndodh me kafshët por me një strategji komplekse të veçantë dhe plotësisht eficiente bile ngandongjehere duke "shfrytëzuar" edhe specie të tjera jo bimore.

Bimët mbijetojnë edhe në kushte shumë të veçanta dhe të vështira siç ndodh me pemët e ashtuquajtura "Hibakujumoku" (bombed tree) të cilat, pas bombardimit atomik të Hiroshima e Nagasaki në Japoni në vitin 1945, vazhdojnë të jenë akoma atje, në zonat e bombarduara.

Për t'u riprodhuar bimët shfrytëzojnë ndihmën e insekteve polenizues për transportimin e pjalmët të lules, ushqehen edhe me kafshë siç është rasti i Dionea muscipola, mashtrojnë, sipas mënyrës së tyre, si në rastin e Ophrys apifera etj.

U deshën studimet e Darwinit mbi origjinën e specieve për të përcaktuar profilin natyror real të bimëve si krijesa jashtëzakonisht të sofistikuar dhe komplekse për të pranuar pastaj më vonë edhe inteligjencën e tyre si diçka të ngjashme me trurin e kafshëve inferiore.

Vetë Darwini plak nuk ka dekluar asnjëherë që bimët janë "qenje inteligjente" nga frika e efektit që një "lajm" i tillë do të kishte mbi botën akademike të asaj kohe. Është i biri Francis që në 2 Shtator të vitit 1908 në kongresin vjetor të British Association for the Advancement of Science, do të deklaronte që "Bimët janë qenje inteligjente", deklaratë e cila nuk është pranuar akoma unanimisht nga komuniteti botëror shkencor edhe pse kanë kaluar më shumë se 120 vjet.

Klorofila është esenca e botës bimore. Ajo ka bërë tokën të banueshme nga organizmat e gjalla. Siç thotë botanisti rus Timiryazev kloroplastet janë unaza që "lidh tokën me diellin".

Dhe asaj po i kërkon ndihmë shkenca sot për zgjidhjet teknologjike të problemeve madhore siç është reduktimi i përmbajtjes së lartë të gazit karbonik të atmosferës shkaktar ndër të tjera edhe i mbingrohjes tokësore. Projektimi sipas modelit bimor mund të shpjerë njeriun në zgjidhjen e problemeve përtej skemave të zakonshme. Imitimi i fotosintezës natyrale si burim energjistik, i pakufizuar në kohë dhe me impakt ekonomik shumë më të ulët, përdorimi i formulave filolaktike të bimëve (të mënyrës së vendosjes të gjetheve të tyre në gjatësi të lastarit) në arkitekturën e ndërtimeve, studimi i lëvizjes së bimëve pa nevojën e energjisë së jashtme etj janë dëshmi e përdorimit të inteligjencës bimore nga ana e njeriut dhe jo e kundërta.

